INVESTITORI

“IPN GROUP” SH.P.K.

Babush i Serbëve, Komuna Ferizaj

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR BAZËN E PRODHIMIT TË BETONIT, KUBËZAVE DHE ELEMENTEVE PREJ BETONIT

Gusht - 2026

1. INFORMACIONET E PËRGJITHSHME

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR BAZËN E PRODHIMIT TË BETONIT, KUBËZAVE DHE ELEMENTEVE PREJ BETONIT, NGA KOMPANIA "IPN GROUP" SH.P.K., BABUSH I SERBËVE, KOMUNA E FERIZAJIT

Ngastra me nr. P-72209079 – 00949 - 1, Zona kadastrale Babush i Serbëve, Komuna e Ferizajit

INVESTITORI	
Aplikuesi	**Albion Vogliqi**
Iinvestitori	**"IPN GROUP" SH.P.K.**
Adresa:	**Rruga Magjistrale Ferizaj - Prishtinë, pn**
Lokacioni:	**Babush i Serbëve, Komuna e Ferizajit**
Tel:	**+383 49 755 503**
Email:	**albi.vogliqi123@gmail.com**

Investitori:

"IPN GROUP" SH.P.K.

_____

Nënshkrimi dhe Vula

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Ndërt. Blerina Bajraktari

_____

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

Gusht - 2026

PËRMBAJTJA:

1. INFORMACIONET E PËRGJITHSHME 2
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR 8
2.1. Kategoria e Projektit të Propozuar 8
2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit 8
2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit 8
2.4. Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit 9
2.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme 13
2.6. Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik 14
2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave 14
2.8. Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit 14
2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme 15
2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave 16
2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin 16
2.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese 16
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR 17
3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti 17
3.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit 17
3.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi 19
3.4. Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit 19
3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë 20
3.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meterologjik 21
3.7. Prezantimi i karakteristikat natyrore 22
3.8. Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit 22
3.9. Rishikimi i objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike 23
3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar 23
3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese 23
3.12. Të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkelogjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme 24
3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj 24

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR 25
4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor 25
5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT 27
5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme 27
5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban dhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një laternative të caktuar duke ju referuar 27
5.3. Vendndodhja ose rruga 28
5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut 28
5.5. Proceset dhe teknologjia e prodhimit 29
5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit 30
5.7. Plani i lokacionit 31
5.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit 32
5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit 33
5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit 33
5.11. Vëllimi i prodhimit 34
5.12. Kontrolli i ndotjes 34
5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar 35
5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit 35
5.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit 35
5.16. Trajnimi 36
5.17. Monitorimi 36
5.18. Planet për situata emergjente 36
5.19. Demolimi dhe rehabilitimi 37
5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit 38
5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim 38
6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS 39
6.1 Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë 39
6.2. Cilësinë e ajrit 39
6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi 39
6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike 40
6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit 40
6.6. Cilësia e ujit 40
6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore 41

6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave 41
6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza 41
6.10. Toka 42
6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës..... 42
6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës 42
6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore..... 42
6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur..... 43
6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike..... 43
6.16. Popullsia lokale 43
6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi 44
6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve 44
6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut..... 44
6.20. Ndikimet socio-ekonomike..... 45
6.21. Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës 45
6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura 45
6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare..... 45
6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia..... 46
6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre..... 46
6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike biodiversitetit, florës dhe faunës, pjesë të natyrorë të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve për egra dhe habitateve të tyre 46
6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve..... 47
6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara 47
6.29. Shfrytëzimi i tokës..... 47
6.30. Infrastruktura komunale 47
6.31. Trafiku 48
6.32. Furnizimi me ujë..... 48
6.33. Energjia..... 48
6.34. Ujërat e zeza 48
6.35. Gjenerimi i mbeturinave..... 49

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit 49
6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis 49
6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit 50
6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese 50
6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis 50
6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit 50
6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit 50
6.43. Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit 51
6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike 51
7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS 52
7.1. Masat e parashikuara me legjislacion 52
7.2. Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha 52
7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit 53
7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis 54
8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS 56
8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis 56
8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të projektit 56
8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis 57
8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar 57
8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera 58
8.6. Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera 58
8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis 59
9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR 60
9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit 60
9.2. Pajtushmeria me pëlqim mjedisor 60
9.3. Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000 61
10. INFORMACIONE SHTESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT 62
10.1. Informacionet dhe karakteristikat shtesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së 62
11. BURIMET E TË DHËNAVE 63
11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së 63
12. SHTOJCA 63
13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT 64

13.1. Hyrje 64
13.2. Përshkrimi i projektit 64
13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse 65
13.4. Përfitimet socio-ekonomike 66
13.5. Përfundim 67

Lista e Figurave

Figura 1.Procesi teknologjik i Punës së bazës për prodhimin e betonit 9
Figura 2.Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Ferizajit ..18
Figura 3.Distanca e kompanisë me qytetin e Ferizajit 18
Figura 4.Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi 19
Figura 5.Distanca e kompanisë me objekt tjera 24
Figura 6.Distanca nga lumi Nerodime 25
Figura 7. Plani i situacioni 32

Lista e Tabelave

Tabela 1. Kapaciteti i planifikuar dhe ai i realizuar i prodhimit të betonit 11
Tabela 2. Kapaciteti i prodhimit të kubëzave, tubave dhe elementeve tjera nga betoni 13

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1.Kategoria e Projektit të Propozuar

Projekti i propozuar nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. i takon kategorisë së aktiviteteve prodhuese dhe ndërtimore, përkatësisht bazë për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit.

Aktiviteti përfshin pranimin dhe deponimin e lëndëve të para, përzierjen e agregatit, çimentos dhe ujit, prodhimin e betonit të gatshëm, formësimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, tharjen, deponimin dhe përgatitjen e produkteve për transport.

Sipas natyrës së projektit, ndikimet e mundshme në mjedis lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën, lëvizjen e mjeteve transportuese, përdorimin e ujit dhe krijimin e mbetjeve nga betoni. Projekti nuk përfshin procese kimike të ndërlikuara, djegie industriale apo transformim termik të materialeve.

Për shkak të karakterit të aktivitetit dhe ndikimeve të mundshme në mjedis, projekti i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

2.2.Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Para fillimit të funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, do të kryhen punët përgatitore në lokacionin e projektit në Babush të Serbëve, Komuna e Ferizajit. Punët përgatitore përfshijnë pastrimin dhe rregullimin e terrenit, nivelimin e sipërfaqes, përcaktimin e hapësirave për vendosjen e pajisjeve prodhuese, si dhe organizimin e zonave për deponimin e agregatit, çimentos, produkteve të gatshme dhe qarkullimin e mjeteve transportuese. Në këtë fazë do të përgatiten bazamentet për pajisjet e prodhimit, do të rregullohen rrugët e brendshme, hapësirat për ngarkim dhe shkarkim, si dhe lidhjet e nevojshme me energji elektrike, furnizim me ujë dhe kanlizimin për largimin e ujerave nga administrate dhe largimin e ujerave te shiut. Punët do të zhvillohen brenda kufijve të ngastrës, duke respektuar kushtet teknike dhe masat për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë fazës përgatitore duhet të shmanget shpërndarja e pluhurit, ndotja e tokës dhe pengimi i qarkullimit përreth lokacionit. Mbeturinat që krijohen gjatë përgatitjes së terrenit duhet të grumbullohen dhe largohen në mënyrë të rregullt.

2.3.Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi i projektit bazohet në prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve të ndryshme prej betonit. Procesi fillon me pranimin e lëndëve të para, si agregati, çimentoja, uji dhe materialet ndihmëse, të cilat deponohen në hapësira të caktuara brenda lokacionit. Agregati dhe

çimentoja do të përdoren për përgatitjen e përzierjes së betonit, ndërsa uji do të përdoret në procesin e përzierjes dhe sipas nevojës për pastrimin e pajisjeve. Përzierja e materialeve do të bëhet përmes pajisjeve mekanike të betonierës, ndërsa betoni i prodhuar do të përdoret për shitje si beton i gatshëm ose për prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit. Prodhimi i kubëzave dhe elementeve prej betonit do të bëhet përmes formësimit në kallëpe ose pajisje të posaçme prodhuese. Pas formësimit, produktet do të vendosen në hapësira të caktuara për tharje dhe forcim, e më pas do të deponohen përkohësisht deri në ngarkim dhe transport. Gjatë funksionimit priten ndikime të kufizuara nga pluhuri, zhurma, lëvizja e mjeteve transportuese, përdorimi i ujit dhe krijimi i mbetjeve nga betoni. Këto ndikime do të menaxhohen përmes masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e mjedisit.

2.4.Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit

Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit. Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rërë apo gur me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset mbushen me anë të lopatës ngarkuese me fraksione të gurit ose rërës nga depoja e fraksioneve të agregatit, siloset janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të qelikut. Proces tjetër paraqitet mbushja e siloseve me çimento të tipit të caktuar, mbushja bëhet me anë të auto-cisternave permes procesit pneumatik. Në procesin teknologjik bëjnë pjesë tërë sistemi i pajimeve të furnizimit me ujë, pompave hidraulike, pneumatikës, pajimeve elektrike dhe automatike.




Figura 1.Procesi teknologjik i Punës së bazës për prodhimin e betonit

- Agregati nga të katër bunkerët dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro- pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet nen siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjer ne enën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjer në mikser (përzierëse) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit, kur të dozohet sasia e dëshiruar e agregatit, në transportier e pastaj nga transportieri shiritor ne enën prej nga dërgohet ne mikser (përzierës).
- Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos, pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përziers) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena ne mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.
- Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3at. dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është $1m^3$, zgjatja e një cikli është përafërsisht 30 sek. në varëshmeri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë emanuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, kryhen këto veprime;

- Sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silosë,
- Caktohet receptura për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë ta prodhojmë,
- Caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar,

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Sigurohet sasia e nevojshme e ujit.

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuele. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për të. Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese. Menaxhimi i ter procesit të prodhimit behet edhe përmes disa monitorëve të vendosur ne panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëj mbikëqyrjen e ter procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këte mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, bitumenit dhe komponentëve tjera shtesë. Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e sajë. (kohëlidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse). Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar Aditivët. Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtë për drejt në mikser. Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2-4% të masës së çimentos. Për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos të ndërtuar nga vet kompania, gjithashtu në mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik të prodhiit te betonit. Përpos pajisjeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe për bartjen e tij gjer te hargjuesi (konsumatori), kompania disponon edhe këtë mekanizëm: auto mikserë për bartjen e çimentos, një pompë të betonit, kamionë për bartjen e fraksioneve të agregatit, kamion kiper dhe një lopatë ngarkuese.

Tabela 1. Kapaciteti i planifikuar dhe ai i realizuar i prodhimit të betonit

Kapaciteti i prodhimit të bazës së betonit	**Maksimali i projektuar**	**I Realizuar**
Në orë - m^3/h	60	40
Në javë - m^3/javë	2,400	1,600
Në muaj - m^3/muaj	9,600	6,400
Në vit - m^3/vitë	96,000	64,000

Procesi Teknologjik i Prodhimit të Kubezave, Tubave dhe Elementeve nga Betoni

Procesi teknologjik i prodhimit të kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera nga betoni është i ngjashëm me procesin e prodhimit të betonit të freskët, por përzierja përgatitet me sasi më të vogël të ujit dhe, sipas nevojës, me përdorim më të theksuar të aditivëve. Kjo bëhet me qëllim që masa e betonit të jetë më e përshtatshme për formësim, vibro-shtypje dhe arritje të qëndrueshmërisë së kërkuar të produkteve finale.

Procesi fillon me përgatitjen e lëndëve të para, ku përfshihen çimentoja, rëra, zhavorri, uji dhe aditivët. Këto materiale dozohen në përpjesëtime të caktuara, varësisht nga lloji i produktit që do të prodhohet. Përzierja realizohet në mikserë të betonit dhe përmes sistemit automatik të dozimit, duke siguruar saktësi në sasinë e agregatit, çimentos, ujit dhe aditivëve.

Pas përgatitjes së përzierjes, materiali kalon në fazën e formimit. Kubëzat dhe elementet dekorative formohen në kallëpe të veçanta përmes derdhjes dhe vibro-shtypjes, ndërsa tubat e betonit mund të prodhohen përmes metodave si vibro-shtypja, centrifugimi ose derdhja në kallëpe. Kjo fazë është e rëndësishme për sigurimin e formës, dimensioneve dhe qëndrueshmërisë së produkteve.

Pas formimit, produktet kalojnë në fazën e ngurtësimit dhe kujdesit pasformues. Gjatë kësaj faze, kubëzat, tubat dhe elementet tjera prej betonit mbahen në kushte të përshtatshme lagështie dhe temperature, në mënyrë që të arrihet fortësia dhe cilësia e nevojshme. Sipas nevojës teknologjike, procesi i kurimit mund të përshpejtohet në kushte të kontrolluara.

Pas ngurtësimit, produktet i nënshtrohen kontrollit të cilësisë. Kontrolli përfshin verifikimin e rezistencës në shtypje, cilësisë së sipërfaqes, dimensioneve, formës dhe qëndrueshmërisë së produktit. Produktet që i plotësojnë kërkesat teknike deponohen në hapësirat e caktuara për produkte finale.

Në fazën e fundit bëhet paketimi, ruajtja dhe përgatitja për transport. Kubëzat dhe elementet tjera vendosen në paleta ose në mënyrë të përshtatshme për të shmangur dëmtimet gjatë ngarkimit, transportit dhe shkarkimit. Transporti realizohet me mjete të përshtatshme, varësisht nga lloji dhe dimensionet e produkteve.

Ky proces mundëson prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve të betonit me cilësi të qëndrueshme, të cilat përdoren në ndërtimtari, infrastrukturë rrugore, kanalizime, rregullim të hapësirave urbane dhe projekte të tjera ndërtimore.

Tabela 2. Kapaciteti i prodhimit të kubëzave, tubave dhe elementeve tjera nga betoni

Kapaciteti i prodhimit të kubëzave, tubave dhe elementeve tjera nga betoni	Maksimal i projektuar	I Realizuar
Në orë - m³/h	40	30
Në javë - m³/javë	1,600	1,200
Në Muaj - m³/muaj	6,400	4,800
Në Vitë - m³/vitë	64,000	48,000

2.5.Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Për realizimin dhe funksionimin e projektit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., nevojiten burime teknike, materiale, energjetike, ujore dhe njerëzore. Burimet kryesore për këtë aktivitet janë agregati, çimentoja, uji Për funksionimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., nevojiten burime materiale, teknike, ujore, energjetike dhe njerëzore.

Burimet kryesore materiale janë agregati me fraksione të ndryshme, çimentoja, uji dhe aditivët. Agregati do të përdoret si material bazë për prodhimin e betonit dhe produkteve prej betonit, ndërsa çimentoja do të përdoret si material lidhës. Aditivët do të përdoren sipas nevojës teknologjike, për përmirësimin e karakteristikave të betonit, sidomos për kohën e ngurtësimit, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e produkteve finale.

Agregati do të deponohet në hapësirat e caktuara brenda lokacionit dhe do të vendoset në bunkerë sipas granulacioneve. Çimentoja do të ruhet në silose të posaçme, të cilat mbushen me auto-cisterna përmes sistemit pneumatik.

Uji për procesin e prodhimit do të sigurohet nga pusi nëntokësor dhe do të akumulohet në rezervuarë, prej nga do të dozohet në mënyrë të programuar në mikser.

Për realizimin e procesit teknologjik do të nevojiten pajisje si bunkerët e agregatit, siloset e çimentos, transportierët, transportuesit kërmillorë për çimento, sistemi i dozimit dhe peshimit, mikseri i betonit, pompat e ujit, kompresori për ajër të komprimuar, pajisjet për prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve prej betonit, kallëpet, auto-mikserët, pompa e betonit, kamionët, kamionët kiper dhe lopata ngarkuese.

Për furnizim me energji elektrike do të shfrytëzohet rrjeti elektrik, ndërsa në rast të mungesës së energjisë kompania mund të përdorë gjeneratorin për sigurimin e vazhdimësisë së procesit të prodhimit. Makineritë lëvizëse dhe mjetet transportuese do të përdorin karburant dizel.

Për funksionimin e bazës do të angazhohet staf teknik dhe operativ, përfshirë operatorë të pajisjeve, punëtorë të prodhimit, shoferë, mirëmbajtës dhe staf për menaxhimin e procesit. Numri i punëtorëve do të përcaktohet sipas kapacitetit të prodhimit dhe organizimit të punës. Përdorimi i këtyre burimeve do të bëhet në mënyrë të kontrolluar, në përputhje me procesin teknologjik, kërkesat teknike të prodhimit dhe masat për mbrojtjen e mjedisit.

2.6. Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Gjatë funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., pritet të krijohen mbeturina dhe emetime të kufizuara, të cilat lidhen kryesisht me manipulimin e lëndëve të para, procesin e përzierjes së betonit, pastrimin e pajisjeve dhe lëvizjen e mjeteve transportuese. Mbeturinat kryesore që mund të krijohen janë mbetjet nga betoni i freskët ose i ngurtësuar, mbetjet nga pastrimi i betonierës dhe pajisjeve prodhuese, ambalazhet nga materialet ndihmëse, mbeturinat komunale nga punëtorët, si dhe mbetje të vogla nga mirëmbajtja e pajisjeve. Sasia e këtyre mbeturinave do të varet nga kapaciteti prodhues, organizimi i punës dhe mirëmbajtja e procesit teknologjik. Mbetjet nga betoni, nëse menaxhohen si duhet, mund të grumbullohen në hapësirë të caktuar dhe të ripërdoren pjesërisht si material mbushës ose të dërgohen për trajtim sipas rregullave në fuqi. Mbeturinat komunale duhet të grumbullohen në kontejnerë të veçantë dhe të largohen përmes operatorit të licencuar ose shërbimit komunal, ndersa mbeturinat nga mirembajtja e pajisjeve duhet të ruhen ndaras nga mbeturtinat tjera, te jene te mbyllura dhe te dergohen tek operatort e licensuar për keto mbeturina.

2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Projekti i propozuar për bazën e prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve tjera nga betoni nuk parasheh proces të trajtimit kimik, riciklimit industrial apo asgjësimit të mbeturinave.

2.8. Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit

Realizimi i projektit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. do të zhvillohet në disa faza kryesore, duke filluar nga përgatitja e lokacionit, vendosja e pajisjeve, funksionalizimi i bazës prodhuese dhe më pas operimi i rregullt i aktivitetit, keto aktivitetet janë planifikuar te ndërtohen për nje periudhe prej 3-6 muaj. Në fazën fillestare do të bëhet pastrimi dhe rregullimi i terrenit, nivelimi i sipërfaqes, përcaktimi i zonave të punës, rregullimi i qarkullimit të brendshëm dhe përgatitja e hapësirave

për vendosjen e pajisjeve prodhuese. Kjo fazë do të realizohet brenda një periudhe të shkurtër, varësisht nga kushtet në terren dhe dinamika e punimeve. Pas përgatitjes së lokacionit do të vazhdohet me vendosjen e pajisjeve për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, përgatitjen e hapësirave për deponimin e agregatit, çimentos dhe produkteve finale, si dhe lidhjen e nevojshme me energji elektrike dhe ujë. Pas përfundimit të instalimit të pajisjeve do të bëhet kontrolli teknik dhe testimi fillestar i funksionimit. Faza e operimit do të fillojë pas përfundimit të punëve përgatitore dhe instalimit të pajisjeve. Gjatë kësaj faze do të zhvillohet prodhimi i betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, deponimi i përkohshëm i produkteve dhe transporti i tyre sipas kërkesave të tregut. Kohëzgjatja e operimit të projektit varet nga kapaciteti prodhues, kërkesat ekonomike dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Pas përfundimit të funksionimit të projektit, lokacioni duhet t'i nënshtrohet fazës së rehabilitimit. Kjo përfshin largimin e pajisjeve prodhuese, pastrimin e sipërfaqes, largimin e mbeturinave, trajtimin e mundshëm të zonave të ndotura, rrafshimin e terrenit dhe kthimin e hapësirës në gjendje të përshtatshme për përdorim të mëvonshëm. Gjatë fazës së rehabilitimit duhet të sigurohet që të mos mbeten mbetje betoni, vajra, materiale të kontaminuara apo mbeturina tjera në lokacion. Të gjitha mbeturinat duhet të largohen përmes operatorëve të autorizuar, ndërsa sipërfaqet e dëmtuara duhet të rregullohen dhe stabilizohen. Qëllimi i rehabilitimit është që lokacioni të mos paraqesë rrezik për mjedisin, tokën, ujërat dhe shëndetin e njerëzve pas ndërprerjes së aktivitetit.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Për funksionimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve tjera prej betonit, nevojitet infrastrukturë teknike dhe përcjellëse e organizuar brenda lokacionit. Kjo përfshin hapësirat për pranimin dhe deponimin e agregatit, bunkerët e agregatit, siloset e çimentos, pajisjet për dozimin dhe përzierjen e materialeve, furnizimin me ujë, energji elektrike, rrugët e brendshme dhe sistemin për trajtimin e ujërave teknologjike.

Qasja në lokacion do të realizohet përmes rrjetit ekzistues rrugor, e cila ka qasje ne magjistralen M2 Prishtinë - Feriazaj. Brenda lokacionit do të organizohen rrugë të brendshme për qarkullimin e kamionëve, auto-mikserëve, pompës së betonit, lopatës ngarkuese dhe mjeteve tjera operative. Po ashtu, do të parashihen hapësira për manovrim, ngarkim, shkarkim dhe parkim të përkohshëm.

Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi nëntokësor brenda lokacionit. Uji do të akumulohet në rezervuarë dhe do të përdoret për prodhimin e betonit, prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, larjen e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës, si dhe për nevoja sanitare. Ujërat

teknologjike nga larja e pajisjeve do të trajtohen përmes sedimentuesit, ndërsa ujërat sanitare do të shkarkohen në gropen septike.

Furnizimi me energji elektrike do të sigurohet nga rrjeti elektrik, ndërsa në rast të mungesës së energjisë kompania mund të përdorë gjeneratorin për vazhdimin e procesit të punës. Përveç kësaj, lokacioni duhet të ketë hapësira për kontejnerë të mbeturinave, vend për mirëmbajtje bazike të pajisjeve, sinjalizim të brendshëm, rrethim dhe masa për siguri në punë.

Kjo infrastrukturë mundëson funksionimin e rregullt të bazës prodhuese, organizimin e qarkullimit të brendshëm dhe menaxhimin më të lehtë të ndikimeve mjedisore gjatë ndërtimit dhe operimit

2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Për zbatimin e projektit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., nuk parashihet ndërtimi i kampeve, rezidencave apo objekteve të veçanta për banim të punëtorëve.

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Për Bazën për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, investitori është i obliguar të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Lejet dhe licencat kryesore që kërkohen për zbatimin e projektit përfshijnë:

1. **Pëlqimi komunal** nga Komuna e Rahovecit për aktivitetin/lokacionin, sipas kompetencave komunale.
2. **Pelqim Mjedisor** nga MMPHI.
3. **Licenca** nga KPMM.
4. **Leja Mjedisore** nga MMPH për operimin e aktivitetit.

2.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Lokacioni ku planifikohet ndërtimi dhe funksionalizimi i bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit ndodhet në një zonë ku në afërsi zhvillohen edhe aktivitete të tjera afariste dhe prodhuese. Projekti i propozuar nuk ka ndërlidhje të drejtpërdrejtë teknologjike me këto biznese, mirëpo mund të ketë ndërlidhje funksionale me sektorin e ndërtimtarisë, pasi produktet si betoni, kubëzat dhe elementet prej betonit përdoren në punime ndërtimore dhe infrastrukturore.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Projekti për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. është planifikuar të ndërtohet në zonën kadastale Babush i Serbëve, Komuna e Ferizajit. Zona e projektit përfshin ngastrën kadastrale me numër:

- P-72209079-00949-1

3.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Vendndodhja e projektit për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. është paraqitur përmes skicës dhe planimetrisë së lokacionit, të cilat ilustrojnë pozitën e projektit në nivel të Republikës së Kosovës, Komunës së Ferizajit dhe Zonës Kadastrale Babush i Serbëve. Në hartën orientuese të Republikës së Kosovës është paraqitur pozita e përgjithshme e lokacionit të projektit, duke e vendosur atë në territorin e Komunës së Ferizajit. Kjo paraqitje shërben për identifikimin e lokacionit në kontekstin më të gjerë hapësinor dhe administrativ. Në paraqitjen e nivelit lokal është evidentuar shtrirja e projektit në zonën kadastrale Babush i Serbëve, ku shihet raporti hapësinor i lokacionit me sipërfaqet përreth, rrjetin rrugor dhe strukturat ekzistuese në afërsi. Kjo mundëson kuptimin më të qartë të pozitës së projektit brenda zonës ku planifikohet zhvillimi i aktivitetit. Në planimetrinë e detajuar paraqitet parcela ku do të ndërtohet baza për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit. Parcela është e theksuar me ngjyrë të veçantë, duke treguar qartë kufijtë e hapësirës së dedikuar për realizimin e projektit. Kjo paraqitje ndihmon në përcaktimin e saktë të vendndodhjes së projektit dhe në vlerësimin e lidhjes së tij me elementet përreth. Skica dhe planimetria e lokacionit shërbejnë si bazë për identifikimin e vendndodhjes së projektit, përcaktimin e zonës së ndikimit dhe vlerësimin e karakteristikave hapësinore e mjedisore të zonës ku planifikohet realizimi i aktivitetit.




Figura 2.Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Ferizajit

Në skicat përkatëse është paraqitur gjithashtu lidhja rrugore e lokacionit të projektit me qytetin e Ferizjait dhe vendbanimet përreth, përmes rrjetit ekzistues rrugor.




Figura 3.Distanca e kompanisë me qytetin e Ferizajit

3.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi

Zona e projektit për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., në Babush i Serbëve, Komuna e Ferizajit, ndodhet jashtë zonës së banimit. Sipas paraqitjes hartografike, vendbanimi ndodhet në distance minimale prej 785.02m.



Figura 4.Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi

3.4. Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Terreni i Komunës së Ferizajt karakterizohet me kushte natyrore të larmishme, të cilat lidhen me pozitën gjeografike, relievin, përbërjen gjeologjike, tokat bujqësore, rrjetin ujor dhe aktivitetin sizmik të rajonit. Në kuadër të gjendjes ekzistuese trajtohen edhe elementet kryesore natyrore të komunës, përfshirë gjeomorfologjinë, klimën, hidrografinë dhe karakteristikat tjera mjedisore të territorit.

Në aspektin pedologjik, zona e Ferizajt përfshin toka me potencial të rëndësishëm bujqësor, sidomos në pjesët fushore dhe përgjatë luginave të lumenjve. Tokat në këto zona janë kryesisht të përshtatshme për kultivim bujqësor, ndërsa në terrenet më të pjerrëta dhe kodrinore cilësia e tokës ndryshon varësisht nga përbërja gjeologjike, pjerrësia dhe shkalla e erozionit. Gjatë

realizimit të projekteve ndërtimore apo zhvillimore duhet të shmanget dëmtimi i panevojshëm i shtresës pjellore të tokës dhe të parashihet menaxhimi i dheut gjatë fazës së punimeve.

Në aspektin gjeomorfologjik, territori i Komunës së Ferizajt përbëhet nga pjesë fushore, kodrinore dhe malore. Zona fushore lidhet kryesisht me rrafshinën e Ferizajt, ndërsa pjesët periferike të komunës kalojnë gradualisht në reliev kodrinor dhe malor. Kjo përbërje e relievit ndikon në mënyrën e shfrytëzimit të tokës, zhvillimin e vendbanimeve, drejtimin e rrjedhave ujore dhe mundësinë e paraqitjes së erozionit në zonat me pjerrësi më të madhe.

Në aspektin gjeologjik, terreni i komunës paraqitet me formacione të ndryshme shkëmbore dhe sedimente të krijuara gjatë periudhave të ndryshme gjeologjike. Në pjesët fushore dominojnë depozitimet më të reja aluviale dhe deluviale, të lidhura me rrjedhat ujore dhe proceset e sedimentimit. Në pjesët kodrinore dhe malore hasen formacione më të vjetra gjeologjike, të cilat ndikojnë në qëndrueshmërinë e terrenit, përshkueshmërinë e tokës dhe mundësinë e zhvillimit të burimeve ujore nëntokësore.

Në aspektin hidrogjeologjik, ujërat nëntokësore lidhen kryesisht me përbërjen litologjike të terrenit dhe me praninë e depozitimeve aluviale përgjatë lumenjve dhe përroskave. Zonat me materiale zhavorrore, ranore dhe aluviale kanë përshkueshmëri më të lartë dhe mundësi më të madhe për akumulim të ujërave nëntokësore. Për këtë arsye, gjatë çdo zhvillimi në terren duhet të merren masa për parandalimin e ndotjes së ujërave nëntokësore, sidomos nga derdhjet aksidentale të vajrave, karburanteve, ujërave të ndotura apo materialeve tjera ndotëse.

Në aspektin hidrografik, Komuna e Ferizajt ka rrjet të zhvilluar të rrjedhave ujore, të cilat ndikojnë në drenazhimin natyror të territorit dhe në kushtet mjedisore të zonës. Rrjedhat ujore dhe zonat pranë tyre duhet të trajtohen me kujdes, duke ruajtur brezat mbrojtës dhe duke parandaluar shkarkimet e pakontrolluara në ujëra sipërfaqësore. Në Planin Zhvillimor Komunal, hidrografia trajtohet si një nga elementet kryesore të gjendjes natyrore të komunës.

Në aspektin sizmologjik, territori i Kosovës, përfshirë edhe Komunën e Ferizajt, bën pjesë në rajon me aktivitet sizmik të mundshëm. Për këtë arsye, çdo objekt apo projekt ndërtimor duhet të projektohet dhe realizohet duke respektuar standardet teknike për qëndrueshmëri ndaj tërmeteve.

3.5.Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Në kuadër të projektit për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., në Babush i Serbëve, Komuna e Ferizajit, furnizimi me ujë është planifikuar të bëhet nga pusi nëntokësor, i cili do të hapet nga kompania për nevojat e projektit.

3.6.Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meterologjik

Të dhënat për kushtet klimatike për Komunën e Ferizajt janë marrë nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për periudhën 1949–2007, të cilat vlejnë edhe për Komunën e Ferizajt dhe të Shtimes. Komuna e Ferizajt karakterizohet me klimë kontinentale, e ngjashme me pjesën më të madhe të Fushës së Kosovës. Lumi më i madh, Nerodime, përshkon territorin e komunës dhe ndikon në veçoritë lokale klimatike dhe hidrografike. Temperatura mesatare vjetore në rajonin e ngushtë të Ferizajt dhe Shtimes është rreth 10°C, ndërsa për pjesët në gradë më të larta është rreth 9°C. Muaji më i nxehtë është korriku dhe gushti, me temperaturë mesatare prej 20.6°C deri 20.5°C, ndërsa muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare prej 1.4°C. Maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është regjistruar në gusht me 37.3°C, ndërsa minimumi absolut në janar me 26.0°C. Sipas të dhënave të IHMK-së, në vitin 1963 në Ferizaj është regjistruar temperatura maksimale ekstreme prej 34.0°C. Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 74.7%. Muaji më i thatë është gushti me 63%, ndërsa muaji me lagështinë më të madhe është janari me 86.1%. Sipas të dhënave, lagështia më e lartë mesatare sillet prej 85.0% deri 87.0% në muajt dhjetor dhe janar, ndërsa vlerat më të ulëta paraqiten në prill dhe maj, me rreth 68.2% deri 68.4%. Vlera më e lartë në janar është 7.3/10, ndërsa vranësira më e ulët paraqitet në gusht me 3.8/10. Në këtë rajon, vranësimi mesatar vjetor është 57%, ku frekuenca e ditëve të kthjellëta është 57 ditë ose 15.9% të vitit. Insolimi mesatar vjetor në Ferizaj është 2,034 orë me diell. Muaji me më së shumti orë me diell është gushti, me 264.6 orë, ndërsa dhjetori karakterizohet me kohën më të shkurtër të insolimit, mesatarisht 63.8 orë. Sasia e reshjeve në këtë rajon nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë gjatë vitit. Sasia mesatare vjetore e reshjeve në Ferizaj dhe Shtime është 673.3 mm. Muaji me më së shumti reshje është maji, me 105.6 mm, ndërsa muaji me më së paku reshje është gushti, me 42.2 mm. Mesatarisht toka e Ferizajt është 51.8 ditë e mbuluar me borë. Në janar ka më së shumti borë, me 17.0 ditë, ndërsa më së paku borë ka në prill, me 1.0 ditë. Në aspektin e erërave, frekuencën më të madhe vjetore në rajonin e Ferizajt dhe Shtimes e kanë erërat verilindore me 226‰, ndërsa më të voglën erërat lindore me 36‰. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është ajo jugperëndimore, me 4.0 m/s, sipas të dhënave të IHMK-së. Shtypja atmosferike në rajonin e Ferizajt dhe Shtimes ndryshon varësisht nga pozita gjeografike dhe kushtet atmosferike. Në përgjithësi, ndryshimet e elementeve atmosferike janë në kufijtë normalë të ndryshimit të shtypjes atmosferike për këtë rajon. Këto karakteristika klimatike duhet të merren parasysh gjatë planifikimit dhe realizimit të projekteve, sidomos për menaxhimin e ujërave atmosferike, ndikimin e reshjeve, periudhat me borë, drejtimin e erërave dhe mundësinë e shpërndarjes së pluhurit apo ndotësve në ajër.

3.7. Prezantimi i karakteristikat natyrore

Komuna e Ferizajt karakterizohet me vlera të rëndësishme natyrore, të cilat lidhen me pozitën gjeografike, relievin, rrjetin hidrografik, tokat bujqësore, sipërfaqet pyjore dhe praninë e habitateve të ndryshme natyrore. Territori i komunës përfshin zona fushore, kodrinore dhe malore, të cilat krijojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e florës dhe faunës, si dhe për formimin e ekosistemeve të ndryshme. Në aspektin natyror, rëndësi të veçantë ka lumi Nerodime, i cili përshkon territorin e Komunës së Ferizajt dhe paraqet një prej elementeve kryesore hidrografike dhe ekologjike të zonës. Në këtë territor gjendet edhe Bifurkacioni i lumit Nerodime, i shpallur rezervat special natyror në vitin 1979. Ky lokalitet paraqet vlerë të veçantë natyrore, pasi lidhet me ndarjen e rrjedhës së lumit dhe me rëndësinë ekologjike, shkencore dhe peizazhore të zonës. Në dokument përmendet gjithashtu zona turistike prej 120 ha, e shpallur në vitin 2002, e cila përfshin hapësirën ndërmjet lumit të vogël dhe lumit të madh të Nerodimes. Komuna e Ferizajt karakterizohet edhe me prani të shpendëve shtegtarë, ndër të cilët përmendet lejleku, i cili ndërton strofulla në zona si Greme, Surqinë dhe në luginën e Nerodimes. Këto zona kanë rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit lokal dhe për mbrojtjen e habitateve natyrore. Po ashtu, në kuadër të ekosistemeve më të gjera të rajonit, sidomos në drejtim të maleve të Sharrit, krijohen kushte për praninë e llojeve të ndryshme të gjitarëve dhe shpendëve, përfshirë lloje me status të mbrojtur kombëtar dhe ndërkombëtar. Megjithatë, gjendja e florës dhe faunës nuk vlerësohet plotësisht e kënaqshme. Sipas Planit Zhvillimor Komunal, faktorët kryesorë që kanë ndikuar negativisht janë gjuetia e paligjshme, peshkimi i pakontrolluar, prerja dhe dëmtimi i pyjeve, djegia e sipërfaqeve pyjore, shkatërrimi i habitateve natyrore, urbanizimi, transporti, turizmi dhe grumbullimi pa kriter i bimëve mjekuese dhe këpurdhave. Këto ndikime kanë shkaktuar presion mbi ekosistemet natyrore dhe mbi diversitetin biologjik të komunës.

3.8. Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit

Peizazhi i Komunës së Ferizajt përbëhet nga një kombinim i hapësirave fushore, zonave bujqësore, rrjedhave ujore, vendbanimeve, sipërfaqeve pyjore dhe pjesëve kodrinore e malore. Kjo e bën peizazhin e komunës të larmishëm dhe me rëndësi natyrore, ekonomike dhe rekreative. Në pjesët fushore dominojnë tokat bujqësore dhe vendbanimet, ndërsa në pjesët më të ngritura paraqiten sipërfaqe pyjore, kullosa dhe terrene me vlera më të theksuara natyrore. Elementi më i rëndësishëm peizazhor dhe natyror i komunës është lumi Nerodime, së bashku me degët dhe hapësirat përreth tij. Lugina e Nerodimes krijon pamje karakteristike natyrore dhe një korridor ekologjik të rëndësishëm për florën dhe faunën. Zona e Bifurkacionit të lumit

Nerodime paraqet një vlerë të veçantë të peizazhit, për shkak të karakterit natyror, hidrografik dhe ekologjik të saj. Në dokument theksohet se kjo zonë është prekur nga ndërhyrjet njerëzore, si ndërtimet, ngushtimet në shtretërit e degëve të lumit dhe derdhja e ujërave të ndotura. Peizazhi i komunës është formuar edhe nga aktivitetet tradicionale si bujqësia dhe blegtoria, të cilat kanë ndikuar në krijimin e hapësirave të hapura bujqësore, kullosave dhe strukturës rurale të vendbanimeve. Këto hapësira kanë rëndësi jo vetëm ekonomike, por edhe vizuale, pasi krijojnë karakterin e peizazhit rural të Ferizajt. Në anën tjetër, zhvillimi urban, ndërtimet, infrastruktura rrugore, aktivitetet ekonomike, turizmi malor, prerja e pyjeve dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore kanë ndikuar në ndryshimin e peizazhit natyror. Sipas dokumentit, zhvillimi i veprimtarive të ndryshme në natyrë, si ndërtimi i vendbanimeve, turizmi malor, prerja e pyjeve dhe gurthyesit, shpesh është bërë pa kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës, duke dëmtuar ekosistemet dhe biodiversitetin.

3.9. Rishikimi i objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Bazuar në të dhënat e disponueshme dhe analizën e lokacionit të projektit, në afërsi të bazës së prodhimit të betonit, kubëzave edhe elementeve prej betoni nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike.

3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Komuna e Ferizajt ka pasur rritje të vazhdueshme të popullsisë gjatë periudhës 1948–2011. Në vitin 1948 komuna kishte 30,435 banorë, ndërsa në vitin 2011 numri i banorëve ka arritur në 108,610 banorë. Kjo tregon se brenda kësaj periudhe numri i popullsisë është rritur për 78,175 banorë. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Ferizajt kishte gjithsej 108,610 banorë. Nga këta, zona urbane kishte 42,628 banorë, ndërsa zonat rurale 65,982 banorë. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë është e përqendruar në vendbanimet rurale dhe periferike të komunës. Rritja e popullsisë ka qenë më e theksuar në periudhat 1961–1971 dhe 1971–1981, ku popullsia është rritur përkatësisht për 41% dhe 42%. Ndërsa në periudhën 1991–2011 rritja ka qenë më e ulët, rreth 4%, për shkak të ndryshimeve demografike dhe migrimeve të periudhës së pasluftës.

3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese

Në afërsi të lokacionit ku planifikohet ndërtimi dhe funksionalizimi i bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, gjenden ne nje zone të rrethuar me biznese dhe aktivitete të ndryshme. Nga ortofotoja e lokacionit vërehet se përreth zonës së projektit ka biznese me karakter afarist, prodhues dhe shërbyes. Vendbanimi më i afërt gjendet në distancë

rreth 785.02 m nga lokacioni i projektit. Duke marrë parasysh këtë distancë, ndikimet e mundshme nga aktiviteti, si zhurma, pluhuri dhe lëvizja e mjeteve transportuese, pritet të jenë të kufizuara ndaj zonës së banimit, me kusht që të zbatohen masat e parapara për mbrojtjen e mjedisit.



Figura 5.Distanca e kompanisë me objekt tjera

3.12. Të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkelogjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme

Bazuar në gjendjen ekzistuese në terren dhe të dhënat në dispozicion për lokalitetin Babushë I Serbëve, Komuna e Ferizajit, në hapësirën ku planifikohet ndërtimi i bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betoni nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., nuk janë identifikuar zona të përcaktuara për kërkime shkencore, vende arkeologjike të regjistruara, zona veçanërisht të ndjeshme mjedisore apo zona me qëllime të veçanta brenda lokacionit të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tij.

3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj

Në afërsi të projektit gjendet Lumi Nerodime, në distancë rreth 215.9 m nga lokacioni. Kompania parasheh vendosjen e sedimentuesit për trajtimin e ujërave teknologjike. Përmes grumbullimit dhe trajtimit të këtyre ujërave në sedimentues, para largimit ose ripërdorimit të tyre, nuk pritet ndikim i drejtpërdrejtë në Lumin Nerodime.




Figura 6.Distanca nga lumi Nerodime

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

4.1.Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Komuna e Ferizajt karakterizohet me pozitë të rëndësishme gjeografike dhe zhvillimore, pasi shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe ka lidhje të mira me komunat përreth. Territori i komunës përfshin zona urbane, zona rurale, toka bujqësore, sipërfaqe pyjore, rrjedha ujore dhe hapësira të përshtatshme për zhvillim ekonomik. Kjo e bën Ferizajn një komunë me potencial të lartë zhvillimi, por njëkohësisht edhe me nevojë për menaxhim të kujdesshëm të faktorëve mjedisor. Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt, mjedisi në komunë duhet të trajtohet si pjesë e rëndësishme e zhvillimit hapësinor, ekonomik dhe social. Gjendja aktuale e mjedisit ndikohet kryesisht nga urbanizimi, zhvillimi i infrastrukturës rrugore, aktivitetet ekonomike, rritja e numrit të automjeteve, menaxhimi i mbeturinave, shkarkimi i ujërave të ndotura dhe zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbra në disa zona urbane. Sa i përket cilësisë së ajrit, ndikimet kryesore lidhen me qarkullimin rrugor, aktivitetet industriale dhe ndotjet që mund të vijnë nga djegia ose keqmenaxhimi i mbeturinave. Në zonat urbane, sidomos afër rrugëve kryesore, shkollave, spitaleve dhe objekteve të ndjeshme, kërkohet kujdes më i madh për mbajtjen e nivelit të ndotjes dhe zhurmës brenda kufijve të pranueshëm. Përmirësimi i cilësisë së ajrit

lidhet me shtimin e gjelbërimit, krijimin e brezave të gjelbër përgjatë rrugëve, përdorimin më të madh të transportit publik dhe përmirësimin e qarkullimit rrugor. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore paraqesin një faktor të rëndësishëm mjedisor për komunën. Lumi Nerodime është rrjedha kryesore ujore që përshkon territorin e Ferizajt. Mbrojtja e lumenjve, burimeve, kaptazheve dhe ujërave nëntokësore është e domosdoshme për ruajtjen e cilësisë së ujit dhe për parandalimin e ndotjes nga ujërat e zeza urbane, ujërat industriale dhe shkarkimet e pakontrolluara. Për këtë arsye, çdo zhvillim i ri duhet të planifikohet në mënyrë që të mos ndikojë negativisht në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjendja e tokës në komunë ndikohet nga përdorimi bujqësor, ndërtimet, infrastruktura dhe aktivitetet ekonomike. Tokat në pjesët e rrafshëta janë më të përshtatshme për bujqësi dhe përqendrojnë numrin më të madh të vendbanimeve, rrugëve dhe objekteve ekonomike. Ruajtja e tokës bujqësore, parandalimi i ndotjes së saj dhe përdorimi racional i hapësirës janë masa të rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm. Në aspektin e biodiversitetit dhe gjelbërimit, komuna ka sipërfaqe pyjore dhe zona natyrore me rëndësi për peizazhin, rekreacionin dhe ekuilibrin ekologjik. Megjithatë, në zonën urbane vërehet nevojë për më shumë hapësira të gjelbra, parqe dhe drunj përgjatë rrugëve. Shtimi i gjelbërimit ndikon pozitivisht në cilësinë e ajrit, uljen e temperaturave urbane, zvogëlimin e pluhurit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët. Zhurma paraqet një faktor tjetër mjedisor, sidomos në zonat ku ka qarkullim të madh të automjeteve, aktivitete ekonomike dhe punime ndërtimore. Niveli i zhurmës duhet të kontrollohet veçanërisht në afërsi të zonave të banimit, shkollave, spitaleve dhe hapësirave publike. Planifikimi i qarkullimit, ndarja e zonave të ndjeshme nga aktivitetet më të zhurmshme dhe respektimi i orareve të punës janë masa të nevojshme për zvogëlimin e ndikimeve. Menaxhimi i mbeturinave mbetet një ndër çështjet kryesore mjedisore. Mbeturinat duhet të grumbullohen, ndahen, transportohen dhe trajtohen në mënyrë të rregullt, me qëllim të parandalimit të ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit. Komuna duhet të vazhdojë me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, ndarjen e tyre në burim, riciklimin dhe eliminimin e deponive ilegale.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Në kuadër të projektit për ndërtimin dhe funksionalizimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., në Babush të Serbëve, Komuna e Ferizajit, janë shqyrtuar disa alternativa të realizueshme.

A. Ndërtimi dhe funksionalizimi i bazës në lokacionin e propozuar - Kjo alternativë parasheh ndërtimin dhe vendosjen e bazës prodhuese në lokacionin e planifikuar. Aktiviteti do të përfshijë pranimin dhe deponimin e agregatit, çimentos dhe materialeve ndihmëse, përgatitjen e betonit, prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, tharjen, deponimin dhe transportin e produkteve finale. Kjo alternativë mundëson organizim të mirë të procesit të punës dhe kontroll më të lehtë të ndikimeve të mundshme në mjedis.

B. Mosrealizimi i projektit - Kjo alternativë nënkupton që baza prodhuese të mos ndërtohet dhe të mos funksionalizohet. Në këtë rast nuk do të ketë ndikime të reja nga ndërtimi, funksionimi i pajisjeve, pluhuri, zhurma, përdorimi i ujit apo lëvizja e mjeteve transportuese. Megjithatë, kjo alternativë do ta pamundësonte zhvillimin e aktivitetit ekonomik të planifikuar nga kompania dhe furnizimin e tregut me beton, kubëza dhe elemente prej betonit.

C. Zhvendosja e projektit në një lokacion tjetër - Kjo alternativë do të kërkonte identifikimin e një lokacioni të ri, procedura të reja të lejeve, investime shtesë dhe ndërtim të infrastrukturës së nevojshme për qasje, energji, ujë dhe organizim të aktivitetit. Po ashtu, zhvendosja mund të krijonte ndikime të reja mjedisore në një zonë tjetër dhe të rriste kostot e realizimit të projektit.

Pas shqyrtimit të alternativave, alternativa A konsiderohet më e përshtatshme, pasi mundëson realizimin e projektit në lokacionin e propozuar, shfrytëzim më të mirë të hapësirës, organizim të rregullt të punës dhe menaxhim më të lehtë të ndikimeve të mundshme mjedisore.

5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban dhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një laternative të caktuar duke ju referuar

Alternativa e propozuar që parasheh ndërtimin dhe funksionalizimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., në Babush të Serbëve, Komuna e Ferizajit, vlerësohet si alternativa më e favorshme. Kjo alternativë mundëson organizim të rregullt të aktivitetit prodhues, shfrytëzim racional të hapësirës dhe vendosje të përshtatshme të pajisjeve për prodhimin e betonit, kubëzave dhe

elementeve prej betonit. Lokacioni ofron kushte për pranimin dhe deponimin e agregatit, çimentos dhe materialeve ndihmëse, për qarkullimin e mjeteve transportuese, si dhe për deponimin e përkohshëm të produkteve finale.

Lokacioni karakterizohet me qasje të lehtë dhe të përshtatshme rrugore, duke pasur lidhje të afërt me magjistralen Ferizaj–Prishtinë dhe autostradën "Arbën Xhaferi". Kjo pozitë mundëson transport më të shpejtë dhe më efikas të lëndës së parë, si dhe shpërndarjen e produktit final. Gjithashtu, zona përreth karakterizohet nga prania e aktiviteteve afariste dhe industriale, çka e bën lokacionin të përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit të planifikuar.

Përzgjedhja e kësaj alternative mundëson edhe zbatimin më të lehtë të masave për kontrollin e pluhurit, zhurmës, ujërave teknologjike, mbeturinave dhe sigurisë në punë. Duke qenë se kompania parasheh trajtimin e ujërave teknologjike përmes sedimentuesit dhe organizimin e kontrolluar të procesit të punës, ndikimet e mundshme në mjedis vlerësohen si të menaxhueshme. Për këto arsye, alternativa e propozuar paraqet zgjidhjen më të përshtatshme për realizimin e projektit, pasi është teknikisht e zbatueshme, ekonomikisht e arsyeshme dhe mjedisorisht e menaxhueshme në krahasim me alternativat e tjera të shqyrtuara.

5.3.Vendndodhja ose rruga

Lokacioni i projektit ka pozitë të favorshme sa i përket qasjes në infrastrukturën rrugore. Qasja në lokacion realizohet përmes rrugëve lokale, të cilat lidhen me magjistralen Ferizaj–Prishtinë dhe me autostradën "Arbën Xhaferi". Kjo pozitë mundëson qarkullim të lehtë të automjeteve transportuese, pranimin e lëndës së parë dhe transportimin e produktit final.

Rrjeti rrugor ekzistues ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të planifikuar, duke mundësuar lidhje të shpejtë me Ferizajn, Prishtinën dhe zonat tjera përreth. Në afërsi të lokacionit zhvillohen edhe aktivitete të ndryshme afariste, tregtare dhe industriale, prandaj zona konsiderohet e përshtatshme për këtë lloj veprimtarie.

Brenda lokacionit do të organizohen rrugë dhe hapësira të brendshme për qarkullimin e kamionëve, ngarkuesve dhe makinerive operative. Gjatë funksionimit të projektit, qarkullimi i mjeteve do të organizohet në mënyrë të kontrolluar, me qëllim që të mos krijohen pengesa në rrugët përreth dhe të minimizohen ndikimet nga pluhuri, zhurma dhe lëvizja e automjeteve.

5.4.Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Duke pasur parasysh se lokacioni i projektit për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, ndodhet jashtë zonës së banimit, nuk pritet të ketë ndikim në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin e banimit. Vendbanimi më i afërt gjendet në distancë rreth 785.02 m

nga lokacioni i projektit. Kjo distancë krijon ndarje të mjaftueshme ndërmjet aktivitetit prodhues dhe zonës së banuar.

Në afërsi të lokacionit gjenden disa biznese dhe aktivitete të ndryshme afariste, të cilat kontribuojnë në ngarkesën e përgjithshme mjedisore të zonës. Ndikimet e mundshme nga aktiviteti i planifikuar lidhen kryesisht me gjenerimin e pluhurit gjatë manipulimit me agregat dhe çimento, zhurmën nga funksionimi i pajisjeve dhe makinerive, lëvizjen e mjeteve transportuese, shfrytëzimin e ujit, si dhe krijimin e ujërave teknologjike gjatë larjes së pajisjeve.

Këto ndikime vlerësohen si kryesisht lokale, të kufizuara në hapësirën e aktivitetit dhe të menaxhueshme përmes zbatimit të masave përkatëse mbrojtëse. Kompania parasheh masa për kontrollin dhe zvogëlimin e pluhurit, mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve dhe makinerive, organizimin e qarkullimit të brendshëm, menaxhimin e duhur të mbeturinave, si dhe trajtimin e ujërave teknologjike përmes sistemit të sedimentimit. Me zbatimin e këtyre masave, nuk priten ndikime të konsiderueshme negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

5.5.Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Në kuadër të projektit për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., do të zhvillohet proces teknologjik kryesisht mekanik dhe i automatizuar. Procesi përfshin pranimin e lëndëve të para, deponimin e agregatit dhe çimentos, dozimin e materialeve, përzierjen në mikser, prodhimin e betonit të freskët, si dhe prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit. Lëndët kryesore që do të përdoren janë agregati me fraksione të ndryshme, çimentoja, uji dhe sipas nevojës aditivët. Agregati sillet në lokacion me kamionë dhe deponohet në hapësirën e caktuar, prej nga me lopatë ngarkuese dërgohet në bunkerët e agregatit. Bunkerët janë të ndarë sipas granulacioneve dhe shërbejnë për dozimin e sasisë së nevojshme të agregatit, varësisht nga receta e betonit që prodhohet. Nga bunkerët, agregati kalon në sistemin e dozimit dhe më pas bartet përmes transportierëve deri në mikser. Çimentoja ruhet në silose të posaçme, të cilat mbushen me auto-cisterna përmes sistemit pneumatik. Nga siloset, çimentoja dërgohet në përzierëse përmes transportuesve kërmillorë dhe sistemit të peshimit. Dozimi i agregatit, çimentos, ujit dhe aditivëve bëhet në mënyrë të programuar përmes sistemit komandues. Uji për procesin e prodhimit do të sigurohet nga pusi nëntokësor dhe do të akumulohet në rezervuarë, prej nga do të dozohet në mikser sipas nevojës teknologjike. Uji përdoret për përgatitjen e betonit, prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, si dhe për larjen e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës. Ujërat teknologjike nga larja do të trajtohen përmes sedimentuesit.

Procesi i prodhimit të kubëzave dhe elementeve prej betonit është i ngjashëm me procesin e prodhimit të betonit, por përzierja përgatitet me më pak ujë dhe me përbërje të përshtatur për formësim. Materiali vendoset në kallëpe ose në pajisje të posaçme për vibro-shtypje, ku formohen kubëzat, tubat dhe elementet e tjera. Pas formësimit, produktet kalojnë në fazën e ngurtësimit, tharjes dhe kontrollit të cilësisë, pastaj deponohen përkohësisht deri në transport. Procesi teknologjik nuk përfshin djegie industriale apo trajtim kimik të materialeve. Ndikimet kryesore gjatë funksionimit lidhen me pluhurin nga manipulimi me agregat dhe çimento, zhurmën nga pajisjet prodhuese, qarkullimin e mjeteve transportuese, ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe mbetjet nga betoni. Për këtë arsye, do të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, mirëmbajtjen e pajisjeve, trajtimin e ujërave në sedimentues, menaxhimin e mbeturinave dhe organizimin e qarkullimit të brendshëm.

5.6.Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Aktiviteti i bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. do të realizohet në mënyrë të organizuar, duke filluar me përgatitjen e lokacionit, vendosjen e pajisjeve prodhuese dhe funksionalizimin e procesit teknologjik. Gjatë operimit, lëndët e para si agregati, çimentoja, uji dhe materialet ndihmëse do të pranohen dhe deponohen në hapësira të caktuara. Më pas ato do të përdoren në procesin e përzierjes për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve të ndryshme prej betonit. Produkti final, betoni i freskët, do të dërgohet menjëherë te operatori apo klienti përkatës. Ndërsa betoni i përgatitur për prodhimin e kubëzave dhe elementeve të tjera prej betoni do të derdhet në kallëpe dhe më pas do të vendoset në hapësirat e dedikuara për tharje dhe forcim. Pas arritjes së qëndrueshmërisë së nevojshme, produktet do të deponohen përkohësisht në zonën e caktuar dhe më pas do të ngarkohen në mjetet transportuese për dërgim te klientët. Puna do të kryhet nga personel i trajnuar, me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale dhe duke respektuar rregullat e sigurisë në punë. Pajisjet dhe makineritë do të mirëmbahen rregullisht, me qëllim funksionimin e sigurt, uljen e zhurmës, parandalimin e defekteve dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis. Gjatë funksionimit do të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, organizimin e qarkullimit të mjeteve, menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujërave teknologjike. Ujërat që krijohen nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës do të trajtohen përmes sedimentuesit, në mënyrë që grimcat e betonit, rërës dhe çimentos të ndahen para ripërdorimit ose largimit të kontrolluar. Me zbatimin e këtyre metodave të punës, funksionimi i projektit do të jetë i kontrolluar dhe ndikimet në mjedis do të mbahen në nivel të menaxhueshëm.

5.7.Plani i lokacionit

Plani i lokacionit për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit përfshin organizimin funksional të hapësirës operative, në përputhje me nevojat teknike të procesit të prodhimit. Në plan parashihen:

- Hapësira për pranimin dhe shkarkimin e agregatit;
- Hapësira për deponimin e agregatit me fraksione të ndryshme;
- Zona për vendosjen e bunkerëve të agregatit;
- Zona për vendosjen e siloseve të çimentos;
- Zona për vendosjen e betonierës dhe pajisjeve për përzierjen e betonit;
- Hapësira për prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit;
- Hapësira për tharjen, forcimin dhe deponimin e produkteve finale;
- Rrugët e brendshme për qarkullimin e kamionëve, auto-mikserëve, lopatës ngarkuese dhe makinerive tjera operative;
- Hapësirat për manovrim, ngarkim, shkarkim dhe parkim të përkohshëm të mjeteve;
- Hapësira për pusin nëntokësor për furnizim me ujë;
- Hapësira për rezervuarët e ujit dhe pajisjet përcjellëse;
- Hapësira për sedimentuesin për trajtimin e ujërave teknologjike;
- Hapësira për kontejnerët e mbeturinave komunale dhe mbetjet nga betoni.

Plani parasheh organizim të qartë të qarkullimit brenda lokacionit, duke siguruar hyrje dhe dalje të kontrolluar të mjeteve transportuese, ndarje funksionale të zonave të punës dhe menaxhim më të lehtë të ndikimeve mjedisore gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës prodhuese.




Figura 7. Plani i situacioni

5.8.Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Për realizimin e projektit, përkatësisht ndërtimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve të prodhuara nga betoni, do të përdoren materiale ndërtimore dhe teknike të përshtatshme për këtë lloj aktiviteti.

Materialet kryesore që do të përdoren gjatë ndërtimit përfshijnë betonin për bazamente dhe pllaka pune, armaturën e çelikut, zhavorrin për shtresat mbajtëse, materialet për rrafshimin dhe stabilizimin e terrenit, elementet metalike për konstruksione ndihmëse, si dhe materialet për rregullimin e rrugëve të brendshme dhe hapësirave operative.

Për ndërtimin e sipërfaqeve të punës do të përdoren materiale rezistente ndaj ngarkesave të makinerive, kamionëve dhe pajisjeve prodhuese. Hapësirat ku do të vendosen betoniera, pajisjet për prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, siloset, bunkerët dhe pajisjet përcjellëse duhet të kenë bazamente të qëndrueshme dhe të përshtatura me ngarkesat teknike.

Në kuadër të projektit parashihet edhe ndërtimi i objektit administrativ, i cili do të shërbejë për nevoja të menaxhimit, administratës, personelit dhe organizimit të punës. Për këtë objekt do të përdoren materiale ndërtimore standarde si beton, armaturë çeliku, tulla ose blloqe ndërtimore,

llaç, materiale hidroizoluese dhe termoizoluese, dyer, dritare, materiale për dysheme, suvatim, fasadë, mbulesë kulmi, instalime elektrike, instalime të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe pajisje sanitare.

Për rregullimin e infrastrukturës përcjellëse do të përdoren materiale për instalime elektrike, tuba për furnizim me ujë, materiale për sistemin e largimit dhe trajtimit të ujërave teknologjike, si dhe materiale për lidhjen me kanalizim për ujërat sanitare. Po ashtu, do të përdoren materiale për rrethimin e lokacionit, sinjalizimin, ndriçimin dhe sigurinë në punë.

Përzgjedhja e materialeve do të bëhet në bazë të qëndrueshmërisë, funksionalitetit dhe përshtatshmërisë për kushtet e punës në bazën prodhuese dhe objektin administrativ. Materialet duhet të jenë cilësore, të sigurta për përdorim dhe të përshtatshme për ndërtimin e një hapësire ku zhvillohet aktivitet prodhues dhe administrativ.

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Projekti për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. është në fazë planifikimi dhe do të realizohet pas pajisjes me pëlqim mjedisor dhe lejet e tjera të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi. Faza e ndërtimit dhe montimit pritet të realizohet brenda një periudhe të kufizuar kohore, varësisht nga kushtet në terren, furnizimi me pajisje dhe organizimi i punës. Afati i operimit do të varet nga jetëgjatësia teknike e pajisjeve, vlefshmëria e lejeve, kërkesa e tregut dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e pajisjeve. Pas përfundimit të funksionimit të projektit, kompania duhet të bëjë largimin e pajisjeve, pastrimin e lokacionit, largimin e mbeturinave dhe rehabilitimin e sipërfaqes sipas kërkesave ligjore. Rehabilitimi do të ketë për qëllim kthimin e lokacionit në gjendje të sigurt dhe të përshtatshme për përdorim të mëvonshëm.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Sipërfaqja e përgjithshme e lokacionit ku planifikohet zhvillimi i aktivitetit është rreth 16,919 m². Brenda kësaj sipërfaqeje do të organizohen të gjitha hapësirat e nevojshme për funksionimin e bazës së prodhimit të betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betoni.

Në këtë sipërfaqe do të përfshihen hapësirat për pranimin dhe shkarkimin e agregatit, deponimin e agregatit sipas fraksioneve, bunkerët e agregatit, siloset e çimentos, betonierja dhe pajisjet për përzierjen e betonit, zona e prodhimit të kubëzave dhe elementeve të tjera prej betoni, si dhe hapësirat për tharjen, forcimin dhe deponimin e produkteve finale.

Po ashtu, në kuadër të parcelës do të vendosen objekti i administratës, rrugët e brendshme për qarkullimin e mjeteve, hapësirat për manovrim, ngarkim, shkarkim dhe parkim të përkohshëm, pusi nëntokësor, rezervuarët e ujit, sedimentuesi për trajtimin e ujërave teknologjike, si dhe sipërfaqet e gjelbra dhe zonat mbrojtëse përgjatë kufirit të parcelës.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i prodhimit për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. do të varet nga kapaciteti teknik i pajisjeve, kërkesat e tregut, organizimi i punës dhe furnizimi me lëndë të parë.

Për prodhimin e betonit të freskët, kapaciteti maksimal i projektuar është 60 m³/orë, ndërsa kapaciteti i realizuar pritet të jetë rreth 40 m³/orë. Në bazë vjetore, kapaciteti maksimal i projektuar është 96,000 m³/vit, ndërsa kapaciteti i realizuar pritet të jetë rreth 64,000 m³/vit.

Për prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve tjera prej betonit, kapaciteti maksimal i projektuar është 40 m³/orë, ndërsa kapaciteti i realizuar pritet të jetë rreth 30 m³/orë. Në bazë vjetore, kapaciteti maksimal i projektuar është 64,000 m³/vit, ndërsa kapaciteti i realizuar pritet të jetë rreth 48,000 m³/vit.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Për projektin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit janë parashikuar masa për kontrollin e ndotjes gjatë ndërtimit dhe funksionimit të aktivitetit. Masat kryesore lidhen me kontrollin e pluhurit, zhurmës, ujërave teknologjike, mbeturinave dhe emetimeve nga mjetet transportuese. Kontrolli i pluhurit do të realizohet përmes organizimit të rregullt të deponimit të agregatit dhe çimentos, mirëmbajtjes së sipërfaqeve të punës, pastrimit të rrugëve të brendshme dhe spërkatjes me ujë gjatë periudhave të thata. Çimentoja duhet të ruhet në mënyrë të kontrolluar, në mënyrë që të shmanget shpërndarja e pluhurit në ajër. Zhurma do të menaxhohet përmes përdorimit të pajisjeve në gjendje të mirë teknike, mirëmbajtjes së rregullt të makinerive dhe organizimit të punës brenda orarit të lejuar. Lëvizja e kamionëve dhe makinerive brenda lokacionit do të bëhet në mënyrë të kontrolluar, për të shmangur ngarkesat e panevojshme në zonën përreth. Ujërat teknologjike që krijohen nga larja e betonierës, pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës do të trajtohen përmes sedimentuesit. Mbeturinat nga betoni, ambalazhet, mbeturinat komunale dhe mbetjet nga mirëmbajtja e pajisjeve do të grumbullohen ndaras dhe do të menaxhohen sipas llojit të tyre. Nuk lejohet hedhja e pakontrolluar, djegia apo deponimi i mbeturinave brenda lokacionit jashtë hapësirave të përcaktuara. Makineritë dhe mjetet transportuese do të mirëmbahen rregullisht, me qëllim zvogëlimin e emetimeve nga motorët dhe parandalimin e rrjedhjeve të vajrave apo

karburanteve. Me zbatimin e këtyre masave, ndotja nga aktiviteti pritet të jetë lokale, e kufizuar dhe e menaxhueshme.

5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar

Në kuadër të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nuk është paraparë trajtim i mbeturinave brenda lokacionit. Të gjitha mbeturinat që krijohen gjatë ndërtimit dhe funksionimit të projektit do të grumbullohen ndaras, sipas llojit të tyre, dhe do të dorëzohen te kompanitë përkatëse të licencuara për trajtimin, riciklimin ose asgjësimin e tyre. Mbeturinat komunale do të vendosen në kontejnerë dhe do të largohen nga kompania komunale ose operatori i autorizuar, ndërsa mbetjet nga betoni, ambalazhet, vajrat e përdorura, filtrat dhe materialet e tjera nga mirëmbajtja do të menaxhohen veçmas, në përputhje me kërkesat ligjore për menaxhimin e mbeturinave.

5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit

Qasja në lokacionin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit në Babush të Serbëve, Komuna e Ferizajit, do të realizohet përmes rrjetit ekzistues rrugor. Ky rrjet mundëson hyrjen dhe daljen e mjeteve transportuese për furnizim me lëndë të parë dhe shpërndarjen e produkteve finale. Brenda lokacionit do të organizohen rrugë të brendshme dhe hapësira për qarkullimin e kamionëve, ngarkuesve dhe makinerive operative. Po ashtu, do të përcaktohen hapësirat për manovrim, ngarkim, shkarkim dhe parkim të përkohshëm të mjeteve.

5.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit

Kompania "IPN GROUP" SH.P.K. është përgjegjëse për respektimin e kërkesave mjedisore gjatë ndërtimit, instalimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit. Përgjegjësia e kompanisë përfshin zbatimin e masave për kontrollin e pluhurit, zhurmës, ujërave teknologjike, mbeturinave dhe emetimeve nga mjetet transportuese. Kompania duhet të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve, funksionimin e sedimentuesit për trajtimin e ujërave teknologjike, si dhe menaxhimin e mbetjeve të betonit dhe mbeturinave tjera sipas kërkesave ligjore. Po ashtu, kompania duhet të organizojë punën në mënyrë të sigurt, të përdorë pajisje të përshtatshme mbrojtëse për punëtorët dhe të parandalojë rrjedhjet e vajrave, karburanteve apo materialeve të tjera që mund të ndotin tokën dhe ujërat. Gjatë funksionimit të bazës, kompania është e obliguar të bashkëpunojë me autoritetet kompetente, të zbatojë kushtet e përcaktuara në pëlqimin mjedisor dhe të sigurojë që aktiviteti të zhvillohet

në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në punë dhe kërkesat teknike të operimit.

5.16. Trajnimi

Kompania duhet të sigurojë trajnimin e punëtorëve për përdorimin e pajisjeve prodhuese, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Trajnimi duhet të përfshijë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, kontrollin e pluhurit, menaxhimin e mbeturinave, parandalimin e rrjedhjeve të vajrave apo karburanteve dhe veprimin në raste aksidentale.

Personeli përgjegjës duhet të jetë i njoftuar edhe me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sedimentuesit për ujërat teknologjike. Trajnimet duhet të përsëriten sipas nevojës, sidomos për punëtorët e rinj ose kur ndryshojnë kushtet teknike të punës.

5.17. Monitorimi

Gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, kompania duhet të bëjë monitorimin e ndikimeve kryesore në mjedis.

Monitorimi duhet të përfshijë kontrollin e pluhurit, zhurmës, mbeturinave, gjendjes së tokës, ujërave teknologjike dhe funksionimit të sedimentuesit.

Kontrolli duhet të bëhet rregullisht nga personeli përgjegjës, ndërsa në rast të ankesave apo kërkesës së institucioneve kompetente, duhet të kryhen matje përkatëse nga subjekte të autorizuara.

Të gjitha të dhënat për monitorimin, mirëmbajtjen e pajisjeve, largimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujërave teknologjike duhet të mbahen të evidentuara nga kompania.

5.18. Planet për situata emergjente

Kompania duhet të ketë plan të qartë për veprim në raste emergjente gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit.

Situatat emergjente që mund të paraqiten janë rrjedhjet aksidentale të vajrave apo karburanteve, defektet në pajisje, zjarri, lëndimet në punë, derdhja e materialeve dhe reshjet e mëdha atmosferike.

Në rast emergjence, puna duhet të ndërpritet menjëherë në zonën e prekur, të izolohet vendi i ngjarjes dhe të ndërmerren masa për pastrim, sigurim dhe parandalim të përhapjes së ndotjes. Për rrjedhje të vajrave apo karburanteve duhet të përdoren materiale absorbuese, ndërsa mbetjet e ndotura duhet të largohen nga operatorë të autorizuar.

Lokacioni duhet të jetë i pajisur me aparate kundër zjarrit, kuti të ndihmës së parë, sinjalizim të nevojshëm dhe numra emergjentë të vendosur në vende të dukshme. Punëtorët duhet të jenë të trajnuar për veprim në raste emergjente dhe për përdorimin e pajisjeve të sigurisë.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Pas përfundimit të funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, kompania "IPN GROUP" SH.P.K. duhet të ndërmarrë masa për demolimin, largimin e pajisjeve dhe rehabilitimin e lokacionit. Kjo fazë duhet të realizohet në mënyrë të kontrolluar, me qëllim që pas ndërprerjes së aktivitetit të mos mbeten materiale apo mbeturina që mund të ndikojnë negativisht në tokë, ujëra, ajër apo sigurinë e njerëzve. Demolimi do të përfshijë çmontimin dhe largimin e pajisjeve prodhuese, si betoniera, pajisjet për prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, silosi apo hapësirat për ruajtjen e çimentos, pajisjet për dozimin dhe përzierjen e materialeve, kallëpet, strukturat ndihmëse metalike, instalimet elektrike dhe pajisjet tjera që kanë qenë pjesë e procesit të punës. Çmontimi duhet të bëhet nga persona të kualifikuar dhe me masa të sigurisë në punë. Gjatë kësaj faze duhet të bëhet largimi i të gjitha mbetjeve që kanë mbetur nga aktiviteti, përfshirë mbetjet e betonit të ngurtësuar, agregatin e papërdorur, ambalazhet, mbeturinat komunale, pjesët metalike, plastikat, vajrat e përdorura, filtrat dhe materialet tjera nga mirëmbajtja e pajisjeve. Mbeturinat duhet të ndahen sipas llojit të tyre dhe të dorëzohen te operatorët e autorizuar ose në vende të lejuara për trajtim dhe deponim. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet hapësirave ku janë vendosur pajisjet prodhuese, sedimentuesi, zonat e larjes së pajisjeve dhe vendet ku janë ruajtur karburantet, vajrat apo materialet ndihmëse. Nëse vërehen njolla, rrjedhje apo ndotje lokale të tokës, ato duhet të pastrohen dhe materiali i kontaminuar duhet të largohet në mënyrë të kontrolluar. Pas largimit të pajisjeve dhe mbeturinave, lokacioni duhet të pastrohet nga mbetjet e betonit, pluhuri, materialet e shpërndara dhe mbeturinat e tjera. Sipërfaqet e dëmtuara duhet të rrafshohen dhe të stabilizohen, ndërsa hapësirat që nuk do të përdoren më duhet të kthehen në gjendje të përshtatshme për përdorim të ardhshëm. Nëse gjatë operimit janë krijuar sipërfaqe të ngjeshura, të dëmtuara apo të mbuluara me material inert, ato duhet të rregullohen sipas nevojës. Rehabilitimi mund të përfshijë rrafshimin e terrenit, largimin e shtresave të panevojshme, mbulimin me material të përshtatshëm dhe rikthimin e sipërfaqes në gjendje stabile. Qëllimi i demolimit dhe rehabilitimit është që pas ndërprerjes së aktivitetit, lokacioni të mos paraqesë burim ndotjeje apo rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Pas përfundimit të rehabilitimit, hapësira duhet të jetë e pastër, e sigurt dhe e përshtatshme për

shfrytëzim të mëvonshëm, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kushtet e përcaktuara nga institucionet kompetente.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani për menaxhimin e mjedisit përcakton masat që duhet të zbatohen gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis.

Gjatë ndërtimit, kompania duhet të sigurojë që punimet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lokacionit, të kontrollohet pluhuri, të menaxhohen mbeturinat ndërtimore dhe të shmangen rrjedhjet e vajrave apo karburanteve nga makineritë.

Gjatë operimit, duhet të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit nga agregati dhe çimentoja, mirëmbajtjen e pajisjeve, organizimin e qarkullimit të brendshëm, menaxhimin e mbetjeve nga betoni dhe grumbullimin e mbeturinave ndaras sipas llojit.

Ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës duhet të trajtohen përmes sedimentuesit, ndërsa ujërat sanitare do të shkarkohen në gropen septike. Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi nëntokësor.

Kompania duhet të mbajë evidencë për mirëmbajtjen e pajisjeve, largimin e mbeturinave, funksionimin e sedimentuesit dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit. Me zbatimin e këtij plani, ndikimet në ajër, tokë, ujëra dhe mjedisin përreth pritet të jenë të kontrolluara dhe të menaxhueshme.

5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa pa veprim nënkupton mosrealizimin e projektit për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

6.1 Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë

Projekti për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. mund të krijojë ndikime të caktuara në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë fazës së operimit. Gjatë ndërtimit, ndikimet lidhen me përgatitjen e terrenit, ndërtimin e bazamenteve, objektit administrativ, rrugëve të brendshme dhe vendosjen e pajisjeve. Në këtë fazë mund të paraqiten pluhur, zhurmë, mbeturina ndërtimore dhe rrjedhje aksidentale nga makineritë.

Gjatë operimit, ndikimet lidhen me pranimin dhe deponimin e agregatit, ruajtjen e çimentos në silose, prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve tjera prej betonit, si dhe qarkullimin e kamionëve dhe auto mikserëve.

Ndikimet kryesore janë pluhuri, zhurma, emetimet nga makineritë, ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve, mbetjet nga betoni dhe mbeturinat komunale. Ujërat teknologjike do të trajtohen përmes sedimentuesit, ndërsa ujërat sanitare do të shkarkohen në gropen septike.

Me zbatimin e masave mbrojtëse, ndikimet pritet të jenë lokale, të kufizuara dhe të menaxhueshme.

6.2. Cilësinë e ajrit

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimi në cilësinë e ajrit mund të paraqitet nga pluhuri që krijohet gjatë pastrimit të terrenit, nivelimit, ndërtimit të bazamenteve, objektit administrativ dhe rrugëve të brendshme. Emetime të kufizuara mund të krijohen edhe nga makineritë dhe mjetet transportuese që përdorin karburant. Këto ndikime janë të përkohshme dhe lidhen vetëm me periudhën e ndërtimit.

Gjatë fazës së operimit, ndikimi në ajër lidhet kryesisht me pluhurin nga deponimi dhe manipulimi me agregat, mbushja e bunkerëve, mbushja e siloseve me çimento, prodhimi i betonit dhe qarkullimi i kamionëve brenda lokacionit. Pluhur mund të krijohet edhe gjatë lëvizjes së auto mikserëve, lopatës ngarkuese dhe mjeteve tjera operative.

Me zbatimin e këtyre masave, ndikimi në cilësinë e ajrit pritet të jetë lokal, i kufizuar dhe i menaxhueshëm gjatë ndërtimit dhe operimit.

6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi

Gjatë fazës së ndërtimit, ndotësit kryesorë në ajër mund të jenë pluhuri nga pastrimi dhe nivelimi i terrenit, ndërtimi i bazamenteve, rrugëve të brendshme dhe objektit administrativ, si

dhe emetimet e kufizuara nga makineritë që përdorin karburant. Këto ndikime janë të përkohshme dhe pritet të jenë të kufizuara brenda lokacionit.

Gjatë fazës së operimit, ndotësit kryesorë në ajër do të jenë grimcat e pluhurit nga deponimi i agregatit, mbushja e bunkerëve, manipulimi me çimento, mbushja e siloseve dhe qarkullimi i kamionëve e auto mikserëve. Sipas procesit teknologjik, çimentoja ruhet në silose dhe mbushja bëhet me auto cisterna përmes sistemit pneumatik, ndërsa mbi silose parashihen filtra për pastrimin e ajrit nga pluhuri gjatë mbushjes dhe zbrazjes.

Emetime të kufizuara mund të krijohen edhe nga lopata ngarkuese, kamionët, auto mikserët dhe pajisjet tjera operative. Meqenëse procesi nuk përfshin djegie industriale apo procese termike, nuk priten përqendrime të larta të ndotësve në ajër.

6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike

Gjatë fazës së ndërtimit, emetimet e gazeve serrë mund të krijohen nga përdorimi i makinerive dhe mjeteve transportuese që funksionojnë me karburant. Këto emetime janë të përkohshme dhe lidhen vetëm me periudhën e realizimit të punimeve. Gjatë fazës së operimit, emetimet e gazeve serrë do të jenë të kufizuara dhe do të vijnë kryesisht nga kamionët, ngarkuesit dhe makineritë ndihmëse. Projekti nuk përfshin djegie industriale apo procese të mëdha energjetike që do të krijonin emetime të larta. Ndikimi i projektit në klimë vlerësohet i ulët. Projekti mund të ndikohet nga reshjet e mëdha ose periudhat e thata, të cilat mund të ndikojnë në qarkullimin e brendshëm, kontrollin e pluhurit dhe menaxhimin e ujërave në lokacion. Me organizim të mirë të punës, këto ndikime mund të menaxhohen.

6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit

Duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit, lokacionin dhe masat e parapara për kontrollin e pluhurit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, nuk pritet që projekti të shkaktojë ndotje të ajrit me përhapje të gjerë apo ndikim jashtë territorit lokal.

6.6. Cilësia e ujit

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimi në cilësinë e ujit mund të paraqitet vetëm në rast të menaxhimit jo të rregullt të materialeve, rrjedhjeve aksidentale të vajrave apo karburanteve nga makineritë, si dhe nga mbeturinat që mund të krijohen gjatë punimeve përgatitore. Këto ndikime janë të përkohshme dhe mund të shmangen me mirëmbajtje të pajisjeve dhe organizim të rregullt të vendpunishtes. Gjatë fazës së operimit, ndikimi i mundshëm në ujë lidhet kryesisht me ujërat teknologjike që krijohen nga larja e betonierës, pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës. Këto ujëra mund të përmbajnë grimca të betonit, çimentos, rërës dhe agregatit, prandaj

kompania parasheh trajtimin e tyre përmes sedimentuesit. Në afërsi të lokacionit gjendet Lumi Nerodime, në distancë rreth 215.9 m. Me trajtimin e ujërave teknologjike në sedimentues, menaxhimin e rregullt të mbeturinave dhe parandalimin e shkarkimeve të pakontrolluara, nuk pritet ndikim në cilësinë e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore.

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Gjatë ndërtimit, ndotësit e mundshëm që mund të ndikojnë në ujëra janë vajrat, karburantet, mbeturinat ndërtimore dhe materialet e imëta që mund të shpëlahen nga reshjet atmosferike. Për këtë arsye, makineritë duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, ndërsa materialet dhe mbeturinat duhet të vendosen në hapësira të kontrolluara. Gjatë operimit, ndotësit kryesorë të mundshëm janë grimcat e çimentos, betonit, rërës dhe agregatit nga larja e pajisjeve, si dhe rrjedhjet eventuale të vajrave apo karburanteve nga mjetet transportuese. Ujërat teknologjike duhet të kalojnë në sedimentues, ku bëhet ndarja e materialeve të ngurta para largimit ose ripërdorimit të tyre. Me zbatimin e këtyre masave, ndikimi i ndotësve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohet i ulët dhe i menaxhueshëm.

6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave

Projekti nuk pritet të ketë ndikim në ndotjen ndërkufitare të ujërave. Aktiviteti zhvillohet në nivel lokal dhe nuk përfshin shkarkime në rrjedha ujore që mund të bartin ndotje jashtë territorit të zonës së projektit.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza

Projekti nuk parasheh ndërhyrje në shtratin e lumenjve, kanaleve apo rrjedhave ujore, prandaj nuk priten ndryshime hidromorfologjike në zonën e projektit. Brenda lokacionit do të bëhet vetëm rregullimi i sipërfaqeve të punës, rrugëve të brendshme dhe hapësirave për vendosjen e pajisjeve prodhuese. Gjatë fazës së ndërtimit mund të krijohen sasi të vogla të ujërave sanitare nga punëtorët dhe ujëra atmosferike nga reshjet. Këto ndikime janë të kufizuara dhe të përkohshme. Gjatë fazës së operimit, ujërat teknologjike që krijohen nga larja e betonierës, pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës do të trajtohen përmes sedimentuesit. Në sedimentues do të bëhet ndarja e grimcave të betonit, çimentos, rërës dhe agregatit, para largimit ose ripërdorimit të ujit sipas mundësisë teknike. Ujërat sanitare nga punëtorët do të shkarkohen në gropen sekptike. Me trajtimin e ujërave teknologjike në sedimentues dhe shkarkimin e ujërave sanitare në gropen septike, nuk pritet ndikim i rëndësishëm në sasinë apo cilësinë e ujërave në zonën e projektit.

6.10. Toka

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimi në tokë mund të paraqitet nga pastrimi dhe rregullimi i terrenit, nivelimi i sipërfaqes, lëvizja e makinerive dhe deponimi i përkohshëm i materialeve. Këto ndikime janë kryesisht lokale dhe të kufizuara brenda lokacionit të projektit. Gjatë fazës së operimit, ndikimi në tokë mund të lidhet me deponimin e agregatit, mbetjet nga betoni, qarkullimin e mjeteve dhe mundësinë e rrjedhjeve aksidentale të vajrave apo karburanteve. Me organizim të rregullt të hapësirave të punës, grumbullim të mbeturinave dhe mirëmbajtje të pajisjeve, nuk pritet ndikim i rëndësishëm në cilësinë e tokës.

6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës

Gjatë ndërtimit mund të ketë ndërhyrje të kufizuara fizike në terren, kryesisht për nivelimin e sipërfaqes, përgatitjen e bazamenteve dhe rregullimin e rrugëve të brendshme. Këto punime nuk pritet të shkaktojnë ndryshime të mëdha në topografinë lokale. Lokacioni nuk paraqet aktivitet që lidhet me gërmime të thella apo shfrytëzim të materialeve natyrore nga toka. Për këtë arsye, nuk pritet rrezik i theksuar nga erozioni apo rrëshqitjet e tokës. Gjatë operimit, ndikimi fizik do të kufizohet në përdorimin e sipërfaqes për prodhim, deponim dhe qarkullim të mjeteve.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës

Gjatë ndërtimit, ndotësit e mundshëm në tokë mund të paraqiten vetëm në rast të rrjedhjeve aksidentale të vajrave, karburanteve apo nga menaxhimi jo i rregullt i mbeturinave ndërtimore. Këto ndikime mund të shmangen me mirëmbajtje të makinerive dhe largim të rregullt të mbeturinave. Gjatë operimit, ndikimi i mundshëm në tokë mund të vijë nga mbetjet e betonit, ujërat nga larja e pajisjeve, pluhuri nga agregati dhe çimentoja, menaxhimi jo I rregullt I mbeturinave si dhe rrjedhjet eventuale nga mjetet transportuese. Kompania parasheh trajtimin e ujërave teknologjike përmes sedimentuesit, grumbullimin e mbetjeve nga betoni dhe menaxhimin e mbeturinave sipas kërkesave ligjore. Me zbatimin e këtyre masave, ndikimi në tokë pritet të jetë i kufizuar dhe brenda niveleve të pranueshme sipas legjislacionit në fuqi.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Projekti do të ndikojë në shfrytëzimin e tokës brenda lokacionit të planifikuar, pasi sipërfaqja do të përdoret për vendosjen e pajisjeve prodhuese, deponimin e agregatit, prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, si dhe qarkullimin e mjeteve. Gjatë ndërtimit,

shfrytëzimi i tokës do të jetë i lidhur me përgatitjen e lokacionit dhe rregullimin e infrastrukturës së brendshme. Gjatë operimit, toka do të përdoret për aktivitet prodhues dhe nuk parashihet shfrytëzim i burimeve natyrore nga vetë lokacioni, përveç përdorimit të ujit dhe materialeve të sjella nga furnitorët. Burimet kryesore të nevojshme për projektin janë agregati, çimentoja, uji dhe energjia elektrike. Përdorimi i tyre do të bëhet sipas nevojave të procesit prodhues dhe në mënyrë të kontrolluar.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ku planifikohet realizimi i projektit është 16,919 m², ndërsa sipërfaqja e planifikuar për shfrytëzim nga projekti është rreth 11,050 m².

Parcela është e evidentuar si tokë kullosë e klasës II. Me ndërtimin dhe funksionimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve prej betonit, sipërfaqja e shfrytëzuar do të përdoret për ndërtimin e bazamenteve, objektit administrativ, rrugëve të brendshme, hapësirave operative, vendosjen e pajisjeve prodhuese, deponimin e agregatit dhe deponimin e produkteve finale.

Duke qenë se toka është kullosë e klasës II, realizimi i projektit paraqet humbje të një sipërfaqeje me potencial për shfrytëzim bujqësor ose blegtoral. Megjithatë, humbja kufizohet vetëm në sipërfaqen e planifikuar prej 11,050 m², ndërsa pjesa tjetër e parcelës nuk do të shfrytëzohet për gjelberim.

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Projekti nuk parasheh shfrytëzim të nëntokës, nxjerrje të materialeve minerale apo ndërhyrje të thella në strukturën gjeologjike të terrenit. Punimet do të kufizohen kryesisht në rregullimin e sipërfaqes, përgatitjen e bazamenteve dhe vendosjen e pajisjeve prodhuese. Për këtë arsye, nuk pritet ndikim i rëndësishëm në karakteristikat gjeologjike apo gjeomorfologjike të zonës. Gjatë ndërtimit dhe operimit duhet të shmangen ndërhyrjet e panevojshme në terren dhe të sigurohet stabiliteti i sipërfaqeve të përdorura për aktivitetin e projektit.

6.16. Popullsia lokale

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimet në popullsinë lokale mund të lidhen me pluhurin, zhurmën, lëvizjen e makinerive dhe transportin e materialeve ndërtimore. Këto ndikime do të jenë të përkohshme dhe do të kufizohen kryesisht brenda periudhës së punimeve.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet e mundshme lidhen me qarkullimin e kamionëve dhe auto mikserëve, zhurmën nga pajisjet prodhuese, si dhe pluhurin nga manipulimi me agregat dhe çimento. Vendbanimi më i afërt gjendet në distancë rreth 785.02 m nga lokacioni, prandaj ndikimi i drejtpërdrejtë në popullsinë lokale pritet të jetë i kufizuar.

.

6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi

Realizimi i projektit nuk pritet të shkaktojë ndryshime në numrin apo strukturën e popullsisë lokale. Projekti nuk parasheh ndërtim të objekteve te banimit, kampeve apo vendosje të përhershme të punëtorëve në lokacion. Punëtorët që do të angazhohen pritet të jenë kryesisht nga zona përreth ose do të udhëtojnë çdo ditë në vendin e punës. Për këtë arsye, projekti nuk pritet të ndikojë në migrim, përqendrim të popullsisë apo ndryshime demografike në zonë.

6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve

Gjatë ndërtimit, ndikimet vizuale mund të paraqiten nga prania e makinerive, materialeve ndërtimore dhe punimeve përgatitore. Këto ndikime do të jenë të përkohshme dhe të kufizuara në periudhën e ndërtimit. Gjatë operimit, ndikimi vizual do të lidhet me praninë e pajisjeve prodhuese, hapësirave për deponimin e agregatit, produkteve prej betonit dhe qarkullimin e mjeteve brenda lokacionit. Duke qenë se vendbanimi më i afërt është rreth 785.02 m larg, dhe zoan eshte e mbushur me biznese tjera, ndikimi vizual do jete i vogel.

6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimet e mundshme në shëndetin e njeriut mund të paraqiten nga pluhuri, zhurma, lëvizja e makinerive dhe transporti i materialeve ndërtimore. Këto ndikime janë të përkohshme dhe lidhen vetëm me periudhën e punimeve. Punëtorët duhet të përdorin pajisje mbrojtëse personale, ndërsa makineritë duhet të mirëmbahen rregullisht.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet kryesore mund të vijnë nga pluhuri gjatë manipulimit me agregat dhe çimento, zhurma nga betoniera, mikseri, bunkerët, transportierët, auto mikserët, kamionët dhe lopata ngarkuese. Procesi teknologjik përfshin pajisje mekanike dhe sisteme automatike të dozimit, prandaj zhurma dhe vibrimet mund të jenë të pranishme kryesisht brenda zonës së punës.

Vibrimet pritet të jenë lokale dhe të kufizuara, kryesisht nga puna e pajisjeve prodhuese dhe lëvizja e mjeteve të rënda. Projekti nuk përfshin procese termike, djegie industriale apo burime të nxehtësisë që mund të ndikojnë në shëndetin e njeriut. Po ashtu, nuk parashihen burime të rrezatimit jonizues apo rrezatime të tjera të dëmshme.

Me zbatimin e masave si kontrolli i pluhurit, përdorimi i filtrave në siloset e çimentos, mirëmbajtja e pajisjeve, respektimi i orarit të punës, përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale

dhe organizimi i qarkullimit të brendshëm, ndikimet në shëndetin e punëtorëve dhe popullsisë përreth pritet të jenë të kufizuara dhe të menaxhueshme.

6.20. Ndikimet socio-ekonomike

Projekti pritet të ketë ndikime pozitive socio-ekonomike, pasi do të krijojë mundësi për punësim dhe do të kontribuojë në zhvillimin e aktivitetit ekonomik lokal. Aktiviteti do të mbështesë sektorin e ndërtimtarisë përmes furnizimit me beton, kubëza dhe elemente prej betonit. Ndikimet negative socio-ekonomike mund të lidhen me qarkullimin e mjeteve transportuese, zhurmën dhe pluhurin, por këto ndikime janë të kufizuara dhe mund të menaxhohen me masa të përshtatshme.

6.21. Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës

Projekti do të ndikojë pozitivisht në sektorin prodhues dhe ndërtimor në Komunën e Ferizajit dhe zonat përreth. Prodhimi i betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit do të ndihmojë në furnizimin e tregut lokal me materiale të nevojshme për ndërtim dhe infrastrukturë. Gjithashtu, projekti mund të krijojë bashkëpunim me biznese të tjera në zonë, si furnitorë të agregatit, transportues, kompani ndërtimore, mirëmbajtës të pajisjeve dhe shërbime të tjera ndihmëse.

6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura

Gjatë fazës së ndërtimit dhe montimit, e cila parashihet të zgjasë rreth 3 deri 6 muaj, pritet të angazhohen rreth 15 deri 25 punëtorë, varësisht nga dinamika e punimeve dhe organizimi i realizimit të projektit. Këtu mund të përfshihen: punëtorë ndërtimi, operatorë të makinerive, shoferë dhe transportues, montues të pajisjeve teknologjike, elektricistë, ujësjellës/kanalizim dhe staf Teknik.

Gjatë fazës së operimit, duke marrë parasysh kapacitetin e realizuar të prodhimit të betonit dhe produkteve prej betonit, pritet të angazhohen rreth 22 deri 30 punëtorë. Këtu përfshihen operatorë të pajisjeve prodhuese, punëtorë për prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve prej betonit, shoferë, operatorë të makinerive, mirëmbajtës dhe staf administrativ. Projekti nuk pritet të shkaktojë humbje të vendeve të punës në sektorët apo zonat përreth, por përkundrazi do të kontribuojë në punësim dhe zhvillim ekonomik lokal.

6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare

Projekti do të kontribuojë në ekonominë lokale dhe rajonale përmes zhvillimit të aktivitetit prodhues, punësimit, furnizimit të sektorit të ndërtimtarisë dhe pagesës së obligimeve ligjore e

tatimore. Në nivel më të gjerë, prodhimi i betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit ndihmon në mbështetjen e projekteve ndërtimore dhe infrastrukturore. Për këtë arsye, projekti mund të konsiderohet si aktivitet me kontribut ekonomik pozitiv, me ndikime mjedisore lokale dhe të menaxhueshme.

6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia

Lokacioni ku planifikohet baza për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit ndodhet në një zonë me karakter të përzier, ku ka rrugë ekzistuese dhe aktivitete afariste. Projekti nuk parasheh shfrytëzim të nëntokës, nxjerrje të materialeve minerale apo ndërhyrje të thella në strukturën gjeologjike të terrenit. Gjatë ndërtimit ndikimi në ekosistem do të jetë i kufizuar në rregullimin e sipërfaqes së lokacionit. Gjatë operimit ndikimet mund të lidhen me pluhurin, zhurmën dhe qarkullimin e mjeteve, por ato pritet të jenë lokale dhe të menaxhueshme.

6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre

Në lokacionin e projektit nuk janë evidentuar habitate të veçanta natyrore apo specie të rralla bimore dhe shtazore. Zona përreth është e ndikuar nga aktivitetet njerëzore, rrugët, sipërfaqet bujqësore dhe bizneset ekzistuese. Gjatë ndërtimit mund të ketë largim të vegjetacionit të ulët brenda sipërfaqes së projektit, por ky ndikim pritet të jetë i kufizuar. Gjatë operimit nuk pritet dëmtim i rëndësishëm i specieve bimore dhe shtazore, me kusht që aktiviteti të zhvillohet brenda kufijve të lokacionit dhe të zbatohen masat për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe mbeturinave.

6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike biodiversitetit, florës dhe faunës, pjesë të natyrorë të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve për egra dhe habitateve të tyre

Projekti nuk parasheh gërmime të thella, shfrytëzim të resurseve minerare apo ndërhyrje në formacione të veçanta gjeologjike dhe gjeomorfologjike. Për këtë arsye, nuk pritet dëmtim i veçorive gjeologjike, paleontologjike apo gjeomorfologjike të zonës. Po ashtu, në zonën e projektit nuk janë evidentuar specie të rralla apo të rrezikuara të florës dhe faunës, as habitate me rëndësi të veçantë natyrore. Ndikimet e mundshme në biodiversitet vlerësohen të ulëta dhe të kufizuara në hapësirën e projektit.

6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Qëllimi i projektit është ndërtimi dhe funksionimi i bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit.

Sipërfaqja e shfrytëzuar do të përdoret për vendosjen e betonierës, siloseve të çimentos, bunkerëve të agregatit, pajisjeve për prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, hapësirave për deponimin e agregatit, tharjen dhe deponimin e produkteve finale, rrugët e brendshme, hapësirat për qarkullim dhe manovrim të mjeteve, sedimentuesin për ujërat teknologjike, pusin nëntokësor dhe objektin administrativ.

Pjesa tjetër e parcelës do të mbetet si hapësirë përcjellëse, rezervë funksionale, zonë sigurie dhe hapësirë e lirë brenda kufijve të lokacionit. Shfrytëzimi i sipërfaqes do të bëhet vetëm brenda zonës së planifikuar, pa zgjerim në tokat përreth.

6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është 16,919 m², ndërsa sipërfaqja e planifikuar për shfrytëzim nga projekti është rreth 11,050 m².

Sipërfaqet e ndërtuara dhe të organizuara do të përfshijnë objektin administrativ, bazamentet për pajisjet prodhuese, betonierën, siloset e çimentos, bunkerët e agregatit, pajisjet për prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve prej betonit, sedimentuesin, rrugët e brendshme dhe hapësirat për manovrim, ngarkim dhe shkarkim.

Sipërfaqet e pandërtuara do të mbeten si hapësira të lira brenda parcelës, zona sigurie, hapësira për qarkullim, hapësira përcjellëse dhe pjesë rezervë për organizimin e lokacionit. Këto sipërfaqe duhet të mirëmbahen dhe të mos përdoren për deponim të pakontrolluar të materialeve apo mbeturinave.

6.29. Shfrytëzimi i tokës

Toka në lokacionin e projektit do të shfrytëzohet për ndërtimin dhe funksionimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit.

Toka do të përdoret për deponimin e agregatit, vendosjen e bunkerëve, siloseve, betonierës, pajisjeve për prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, qarkullimin e mjeteve, sedimentuesin, pusin nëntokësor dhe hapësirat për produktet finale. Procesi teknologjik përfshin përdorimin e agregatit, çimentos, ujit dhe pajisjeve për prodhimin e betonit dhe produkteve prej betonit.

6.30. Infrastruktura komunale

Lokacioni i projektit ndodhet në një zonë ku ekziston infrastrukturë bazike për zhvillimin e aktivitetit. Për funksionimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej

betonit do të shfrytëzohet infrastruktura ekzistuese rrugore, furnizimi me energji elektrike dhe furnizimi me ujë, ndersa sistemi i kanalizimit të fshatit për ujërat sanitare, pritet te behet ne te ardhmen. Projekti nuk pritet të krijojë ngarkesë të madhe në infrastrukturën komunale, me kusht që qarkullimi i mjeteve, menaxhimi i ujërave dhe largimi i mbeturinave të organizohen në mënyrë të rregullt.

6.31. Trafiku

Gjatë fazës së ndërtimit, trafiku mund të rritet përkohësisht për shkak të transportit të materialeve, pajisjeve dhe makinerive për përgatitjen e lokacionit. Ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe i kufizuar në periudhën e realizimit të punimeve. Gjatë operimit, trafiku do të lidhet me furnizimin me agregat, çimento dhe materiale ndihmëse, si dhe me transportin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit drejt tregut. Qarkullimi i mjeteve duhet të organizohet në mënyrë të rregullt, duke shmangur pengesat në rrugët lokale dhe duke kufizuar pluhurin e zhurmën nga lëvizja e automjeteve.

6.32. Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë për nevojat e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit do të bëhet nga pusi nëntokësor i planifikuar brenda lokacionit të projektit. Gjatë fazës së ndërtimit, uji do të përdoret në sasi të kufizuar për nevoja të punimeve, pastrim dhe mirëmbajtje të vendpunishtes. Gjatë fazës së operimit, uji do të përdoret për përgatitjen e betonit, prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, larjen e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës, si dhe për nevoja sanitare të punëtorëve. Përdorimi i ujit duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar, sipas nevojave të procesit prodhues. Ujërat teknologjike që krijohen nga larja e pajisjeve do të trajtohen përmes sedimentuesit, ndërsa ujërat sanitare do të shkarkohen në .

6.33. Energjia

Për funksionimin e bazës do të nevojitet energji elektrike për pajisjet prodhuese, ndriçimin, pajisjet ndihmëse dhe hapësirat administrative. Gjatë fazës së ndërtimit, energjia do të përdoret për punime përgatitore, montim dhe instalim të pajisjeve. Gjatë operimit, konsumi i energjisë do të varet nga kapaciteti i prodhimit dhe orari i punës. Makineritë lëvizëse dhe mjetet transportuese mund të përdorin karburant dizel. Pajisjet duhet të mirëmbahen rregullisht për të siguruar përdorim efikas të energjisë dhe funksionim të sigurt.

6.34. Ujërat e zeza

Gjatë fazës së ndërtimit mund të krijohen sasi të vogla të ujërave sanitare nga punëtorët, të cilat duhet të menaxhohen në mënyrë të rregullt. Gjatë fazës së operimit, ujërat sanitare nga

punëtorët do të shkarkohen në gropen septike. Ndërsa ujërat teknologjike që krijohen nga larja e betonierës, pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës do të trajtohen përmes sedimentuesit. Në këtë mënyrë bëhet ndarja e grimcave të betonit, rërës dhe çimentos para largimit ose ripërdorimit të ujit. Me këtë mënyrë të menaxhimit, nuk pritet ndikim i rëndësishëm nga ujërat e zeza apo ujërat teknologjike.

6.35. Gjenerimi i mbeturinave

Gjatë ndërtimit mund të krijohen mbeturina nga materialet ndërtimore, ambalazhet, mbeturinat komunale nga punëtorët dhe mbetje të tjera të përkohshme nga përgatitja e lokacionit. Këto mbeturina duhet të grumbullohen dhe të largohen në mënyrë të rregullt.

Gjatë operimit, mbeturinat kryesore do të gjenerohen janë mbetjet nga betoni, ambalazhet, mbeturinat komunale dhe mbetjet nga mirëmbajtja e pajisjeve. Mbetjet nga betoni duhet të grumbullohen në hapësirë të caktuar dhe do të përdoren për mbushjen e rrugëve. Mbeturinat komunale do të vendosen në kontejnerë dhe do të largohen nga kompania komunale ose operatori i autorizuar, ndersa mbetjet nga mirembajtja e pajisjeve duhet te grumbullohen ndaras dhe te mbulohen me kape, pastaj te mirren nga operator te licencuar per trajtimin e tyre.

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit

Në lokacionin e projektit dhe në afërsi të drejtpërdrejtë të tij nuk janë evidentuar pasuri të mbrojtura natyrore apo kulturore që mund të ndikohen drejtpërdrejt nga zhvillimi i aktivitetit. Zona përreth ka karakter të përzier, me sipërfaqe bujqësore, rrugë ekzistuese dhe aktivitete afariste.

6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis

Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshin ndikimet që mund të paraqiten gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe, sipas rastit, pas ndërprerjes së aktivitetit. Për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, ndikimet kryesore lidhen me pluhurin, zhurmën, qarkullimin e mjeteve, përdorimin e ujit, ujërat teknologjike, mbetjet nga betoni dhe mbeturinat e zakonshme. Këto ndikime janë kryesisht lokale dhe të menaxhueshme, me kusht që të zbatohen masat për kontrollin e pluhurit, mirëmbajtjen e pajisjeve, trajtimin e ujërave teknologjike përmes sedimentuesit dhe menaxhimin e rregullt të mbeturinave.

6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit

Gjatë zbatimit të projektit do të kryhen punë përgatitore, rregullimi i terrenit, vendosja e pajisjeve prodhuese, organizimi i hapësirave për deponim dhe qarkullim, si dhe lidhja me infrastrukturën e nevojshme.

Punimet e largimit mund të paraqiten në rast të ndërprerjes së aktivitetit ose mbylljes së projektit. Në këtë rast, pajisjet prodhuese, siloset, betoniera, bunkerët, makineritë dhe instalimet ndihmëse duhet të largohen në mënyrë të kontrolluar. Mbetjet nga betoni, materialet ndërtimore, mbeturinat metalike, vajrat, filtrat dhe mbeturinat tjera duhet të grumbullohen ndaras dhe të dorëzohen te operatorët e autorizuar.

Pas largimit të pajisjeve, lokacioni duhet të pastrohet, sipërfaqet e dëmtuara të rrafshohen dhe, sipas nevojës, të rehabilitohen. Me zbatimin e këtyre masave, ndikimet nga ndërtimi, operimi dhe largimi i projektit pritet të jenë lokale, të kufizuara dhe të menaxhueshme

6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese

Në afërsi të lokacionit gjenden edhe biznese dhe aktivitete të tjera afariste e prodhuese. Për këtë arsye, ndikimet kumulative mund të lidhen kryesisht me qarkullimin e mjeteve, pluhurin, zhurmën dhe ngarkesën në rrugët ekzistuese. Megjithatë, projekti nuk ka ndërlidhje të drejtpërdrejtë teknologjike me aktivitetet tjera përreth. Me organizimin e qarkullimit të brendshëm, kontrollin e pluhurit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, ndikimet kumulative pritet të jenë të kufizuara dhe të menaxhueshme.

6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Ndikimet e mundshme negative të projektit pritet të jenë kryesisht lokale dhe të kufizuara brenda lokacionit të projektit dhe afërsisë së tij të drejtpërdrejtë. Gjatë ndërtimit, ndikimet mund të lidhen me pluhurin, zhurmën dhe qarkullimin e makinerive. Gjatë operimit, ndikimet mund të paraqiten nga manipulimi me agregat dhe çimento, funksionimi i pajisjeve, qarkullimi i kamionëve dhe krijimi i ujërave teknologjike. Duke marrë parasysh se vendbanimi më i afërt është rreth 785.02 m larg dhe ujërat teknologjike do të trajtohen përmes sedimentuesit, nuk pritet shtrirje e gjerë e ndikimeve negative në mjedis.

6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit

Gjatë fazës së ndërtimit nuk pritet krijim i ujërave të ndotura.

6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit

Gjatë fazës së ndërtimit nuk priten emetime të rëndësishme të rrezatimit elektromagnetik. Pajisjet që do të përdoren gjatë punimeve janë makineri dhe pajisje të zakonshme ndërtimore,

të cilat nuk paraqesin burim të veçantë të rrezatimit elektromagnetik. Për këtë arsye, ndikimi nga rrezatimi elektromagnetik gjatë ndërtimit vlerësohet i papërfillshëm.

6.43. Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit

Gjatë fazës së operimit, emetimet e gazeve serrë do të jenë të kufizuara dhe do të krijohen kryesisht nga kamionët, ngarkuesit dhe makineritë ndihmëse që përdorin karburant dizel. Projekti nuk përfshin djegie industriale apo procese termike që do të krijonin emetime të larta të gazeve serrë. Vëllimi i emetimeve do të varet nga intensiteti i punës, numri i mjeteve dhe organizimi i transportit. Me mirëmbajtje të rregullt të automjeteve dhe organizim të qarkullimit, këto emetime do të mbeten lokale dhe të kufizuara.

6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike

Projekti nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në ndryshimet klimatike, pasi aktiviteti nuk përfshin burime të mëdha të emetimeve atmosferike. Ndikimi i mundshëm lidhet vetëm me përdorimin e mjeteve transportuese dhe makinerive ndihmëse. Nga ana tjetër, projekti mund të ndikohet nga kushtet klimatike, si reshjet e mëdha apo periudhat e thata. Reshjet mund të ndikojnë në menaxhimin e ujërave në lokacion, ndërsa periudhat e thata mund të rrisin krijimin e pluhurit. Me organizim të mirë të punës, spërkatje të sipërfaqeve dhe trajtim të ujërave teknologjike përmes sedimentuesit, këto ndikime mund të menaxhohen.

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

7.1. Masat e parashikuara me legjislacion

Për Për ndërtimin dhe funksionimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, kompania "IPN GROUP" SH.P.K. duhet të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e ajrit, ujërave, tokës, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen nga zhurma dhe sigurinë në punë.

Gjatë fazës së ndërtimit, punimet duhet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lokacionit të miratuar. Duhet të merren masa për kufizimin e pluhurit, menaxhimin e mbeturinave ndërtimore, mirëmbajtjen e makinerive dhe parandalimin e rrjedhjeve aksidentale të vajrave apo karburanteve.

Gjatë fazës së operimit, kompania duhet të sigurojë kontrollin e pluhurit nga agregati dhe çimentoja, mirëmbajtjen e pajisjeve prodhuese, funksionimin e filtrave në siloset e çimentos, trajtimin e ujërave teknologjike përmes sedimentuesit dhe menaxhimin e rregullt të mbeturinave.

Ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës nuk duhet të shkarkohen pa trajtim paraprak. Ato duhet të kalojnë përmes sedimentuesit, ndërsa ujërat sanitare do të shkarkohen në gropen septike, e cila do pastrohet nga kompanti adekuate si[pas nevojes.

Mbeturinat që krijohen gjatë ndërtimit dhe operimit duhet të grumbullohen ndaras sipas llojit të tyre dhe të dorëzohen te operatorët përkatës të autorizuar. Nuk lejohet hedhja e pakontrolluar, djegia apo deponimi i mbeturinave jashtë hapësirave të caktuara.

Me zbatimin e këtyre masave, projekti do të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe ndikimet në mjedis do të mbahen në nivel të kontrolluar dhe të menaxhueshëm.

7.2. Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha

Gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, mund të paraqiten raste aksidentale si rrjedhje e vajrave apo karburanteve, defekte në pajisje, zjarr, lëndime të punëtorëve, derdhje e materialeve, bllokim i sedimentuesit ose reshje të mëdha atmosferike.

Në rast të rrjedhjes së vajrave apo karburanteve, puna në zonën e prekur duhet të ndërpritet menjëherë. Vendi duhet të izolohet, ndërsa ndotja duhet të pastrohet me materiale absorbuese. Materiali i kontaminuar duhet të grumbullohet veçmas dhe t'i dorëzohet operatorit të autorizuar.

Në rast zjarri, duhet të përdoren pajisjet për shuarjen e zjarrit dhe të njoftohen menjëherë shërbimet emergjente. Lokacioni duhet të jetë i pajisur me aparate kundër zjarrit, kuti të ndihmës së parë, sinjalizim dhe qasje të lirë për automjetet emergjente.
Në rast të defekteve në pajisje, puna duhet të ndalet deri në kontrollimin dhe riparimin e tyre. Pajisjet nuk duhet të përdoren nëse paraqesin rrezik për punëtorët, mjedisin apo procesin e prodhimit.
Në rast të reshjeve të mëdha, duhet të kontrollohet qarkullimi i ujërave brenda lokacionit dhe funksionimi i sedimentuesit, në mënyrë që të shmanget bartja e materialeve të imëta, betonit apo çimentos jashtë zonës së projektit.
Punëtorët duhet të jenë të trajnuar për veprim në raste emergjente dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale. Çdo aksident duhet të evidentohet, të raportohet sipas kërkesave ligjore dhe të ndërmerren masa për të parandaluar përsëritjen e tij.

7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit

Për mbrojtjen e mjedisit gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit, kompania "IPN GROUP" SH.P.K. duhet të zbatojë zgjidhje teknike dhe organizative që zvogëlojnë ndikimet në ajër, ujë, tokë dhe mjedisin përreth.
Për kontrollin e pluhurit duhet të bëhet pastrimi i rregullt i sipërfaqeve operative, spërkatja me ujë e rrugëve të brendshme gjatë periudhave të thata dhe kufizimi i shpejtësisë së mjeteve brenda lokacionit. Çimentoja duhet të ruhet në silose të mbyllura dhe siloset duhet të jenë të pajisura me filtra për zvogëlimin e pluhurit gjatë mbushjes dhe zbrazjes.
Për mbrojtjen e ujërave, ujërat teknologjike nga larja e betonierës, pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës duhet të grumbullohen dhe të trajtohen përmes sedimentuesit. Në sedimentues bëhet ndarja e grimcave të betonit, rërës dhe çimentos, para largimit ose ripërdorimit të ujit sipas mundësisë teknike.
Ujërat sanitare nga punëtorët do të grumbullohen në gropë septike të papërshkueshme nga uji. Gropa septike duhet të mirëmbahet rregullisht dhe të zbrazet nga operatorë të autorizuar, sipas nevojës dhe kërkesave ligjore.
Për mbrojtjen e tokës duhet të shmangen rrjedhjet e vajrave, karburanteve dhe materialeve të tjera ndotëse. Makineritë dhe mjetet transportuese duhet të mirëmbahen rregullisht, ndërsa në rast të rrjedhjeve aksidentale duhet të bëhet pastrimi i menjëhershëm i zonës së ndotur.
Mbeturinat që krijohen gjatë ndërtimit dhe funksionimit duhet të grumbullohen ndaras sipas llojit të tyre. Mbeturinat komunale do të vendosen në kontejnerë dhe do të largohen nga

kompania komunale ose operatori i autorizuar. Mbetjet nga betoni dhe materialet tjera inerte duhet të grumbullohen në hapësira të caktuara dhe të menaxhohen në mënyrë të kontrolluar.
Për zvogëlimin e zhurmës duhet të përdoren pajisje në gjendje të mirë teknike, të bëhet mirëmbajtja e rregullt e tyre dhe puna të zhvillohet brenda orarit të përcaktuar. Po ashtu, qarkullimi i kamionëve, auto-mikserëve dhe makinerive tjera duhet të organizohet në mënyrë që të shmangen lëvizjet e panevojshme.
Këto zgjidhje teknike dhe masa organizative do të mundësojnë funksionimin e kontrolluar të projektit dhe zvogëlimin e ndikimeve të mundshme në mjedis gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe operimit.

7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis

Përveç masave teknike dhe ligjore, gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., duhet të zbatohen edhe masa shtesë për mbrojtjen e mjedisit:

- Të kufizohet lëvizja e makinerive dhe mjeteve transportuese vetëm në rrugët dhe hapësirat e përcaktuara brenda lokacionit;
- Të shmanget dëmtimi i panevojshëm i vegjetacionit dhe sipërfaqeve përreth zonës së projektit;
- Të respektohet orari i punës për të kufizuar ndikimet nga zhurma ndaj bizneseve përreth dhe vendbanimit më të afërt;
- Të përdoren pajisje mbrojtëse personale nga punëtorët, sidomos gjatë punës pranë betonierës, pajisjeve për prodhimin e kubëzave dhe elementeve prej betonit, zonave të ngarkimit dhe shkarkimit;
- Të vendosen shenja paralajmëruese dhe informuese në zonën e punës, në hyrje të lokacionit dhe pranë pajisjeve prodhuese;
- Të bëhet kontroll i rregullt i gjendjes teknike të pajisjeve, betonierës, makinerive dhe mjeteve transportuese;
- Të bëhet monitorim periodik i ndikimeve kryesore, sidomos pluhurit, zhurmës, mbeturinave, ujërave teknologjike dhe gjendjes së tokës;
- Të mbahet lokacioni i pastër dhe i organizuar gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit;
- Të mos lejohet grumbullimi i pakontrolluar i agregatit, çimentos, mbetjeve të betonit apo materialeve të tjera jashtë zonave të përcaktuara;

- Të bëhet pastrimi i rregullt i rrugëve të brendshme, hapësirave operative dhe zonave ku bëhet ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve;
- Të sigurohet funksionimi i rregullt i sedimentuesit për trajtimin e ujërave teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës;
- Të mos lejohet shkarkimi i ujërave teknologjike në tokë, kanale të hapura apo rrjedha ujore pa trajtim paraprak;
- Të ndërpritet puna përkohësisht në kushte të pafavorshme atmosferike, nëse krijohet përhapje e madhe e pluhurit apo rrezik për sigurinë e punëtorëve.

Zbatimi i këtyre masave siguron që ndikimet e projektit në ajër, tokë, ujë, biodiversitet, peizazh dhe popullsi të jenë të kufizuara, të kontrolluara dhe të menaxhueshme gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit të bazës prodhuese.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit ka për qëllim kontrollimin e ndikimeve që mund të paraqiten gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë fazës së operimit.

Gjatë ndërtimit duhet të monitorohen pluhuri, zhurma, lëvizja e makinerive, menaxhimi i mbeturinave ndërtimore dhe mundësia e rrjedhjeve aksidentale të vajrave apo karburanteve. Kontrolli duhet të bëhet rregullisht nga personeli përgjegjës në lokacion.

Gjatë operimit duhet të monitorohen pluhuri nga agregati dhe çimentoja, zhurma nga pajisjet prodhuese, gjendja teknike e makinerive, menaxhimi i mbetjeve nga betoni, grumbullimi i mbeturinave ndaras, funksionimi i sedimentuesit për ujërat teknologjike dhe gjendja e gropës septike për ujërat sanitare.

Monitorimi duhet të realizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojës, sidomos gjatë periudhave me aktivitet më të lartë prodhues, gjatë motit të thatë ose në rast të ankesave nga bizneset apo banorët përreth. Nëse kërkohet nga institucionet kompetente, duhet të kryhen edhe matje përkatëse nga subjekte të autorizuara.

Të dhënat nga monitorimi, mirëmbajtja e pajisjeve, largimi i mbeturinave dhe trajtimi i ujërave teknologjike duhet të mbahen të evidentuara nga kompania, në mënyrë që të dëshmohet zbatimi i masave për mbrojtjen e mjedisit.

8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të projektit

Para fillimit të realizimit të projektit, lokacioni paraqitet si sipërfaqe tokësore kryesisht e pazhvilluar, pa objekte të rëndësishme industriale brenda parcelës. Në zonën përreth zhvillohen aktivitete të ndryshme afariste dhe ekonomike, ndërsa qasja në lokacion mundësohet përmes rrjetit ekzistues rrugor.

Gjendja aktuale e mjedisit në lokacion karakterizohet nga ndikime të zakonshme të zonës, si qarkullimi i automjeteve, aktivitetet e bizneseve përreth, pluhuri dhe zhurma nga trafiku dhe veprimtaritë ekzistuese. Brenda parcelës nuk evidentohen burime të rëndësishme të emetimeve në ajër, ujë apo tokë që lidhen me aktivitetin e planifikuar, pasi projekti ende nuk ka filluar të funksionojë.

Toka aktualisht nuk është e ngarkuar me proceset e prodhimit të betonit, ndërsa nuk gjenerohen ujëra teknologjike, mbetje nga betoni apo emetime nga siloset dhe pajisjet prodhuese. Me fillimin e projektit, këto ndikime do të menaxhohen përmes masave teknike dhe organizative të parapara në kuadër të projektit.

Në përgjithësi, gjendja mjedisore para fillimit të projektit vlerësohet si e zakonshme për një zonë me zhvillim afarist dhe me ndikime të kufizuara nga aktivitetet ekzistuese në rrethinë.

8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Efektet e mundshme të dëmshme në mjedis nga funksionimi i bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betoni mund të përcaktohen përmes monitorimit dhe vlerësimit të disa parametrave kryesorë mjedisorë.

Këta parametra përfshijnë cilësinë e ajrit, veçanërisht praninë e pluhurit dhe grimcave të pezulluara që mund të krijohen gjatë pranimit, deponimit dhe manipulimit me agregat dhe çimento. Gjithashtu, duhet të vlerësohet niveli i zhurmës që krijohet nga betoniera, makineritë, lopata ngarkuese, auto-mikserët dhe mjetet tjera transportuese.

Për vlerësimin e ndikimit në ujë dhe tokë merren parasysh sasia dhe cilësia e ujërave teknologjike të krijuara gjatë larjes së pajisjeve, funksionimi i sedimentuesit, mundësia e rrjedhjeve aksidentale të karburanteve apo vajrave, si dhe mënyra e menaxhimit të mbetjeve të betonit dhe mbeturinave tjera.

Parametra të tjerë të rëndësishëm janë intensiteti i trafikut të mjeteve të rënda, gjendja e sipërfaqeve të brendshme, përdorimi i ujit, gjenerimi dhe menaxhimi i mbeturinave, si dhe gjendja e sipërfaqeve të gjelbra dhe zonave mbrojtëse.

Në bazë të këtyre parametrave mund të përcaktohet shkalla, kohëzgjatja dhe shtrirja e ndikimeve të projektit në ajër, ujë, tokë, nivelin e zhurmës dhe në mjedisin përreth.

8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Monitorimi i parametrave mjedisorë do të realizohet në pikat ku pritet të paraqiten ndikimet më të theksuara nga aktiviteti i bazës së prodhimit të betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betoni.

Matjet e cilësisë së ajrit dhe pluhurit rekomandohet të kryhen në afërsi të zonës së pranimit dhe deponimit të agregatit, pranë siloseve të çimentos dhe në kufijtë e parcelës, veçanërisht në drejtim të zonave më të ndjeshme përreth. Matjet do të realizohen me pajisje të përshtatshme për përcaktimin e grimcave të pezulluara dhe pluhurit.

Matjet e zhurmës do të kryhen në afërsi të burimeve kryesore të zhurmës, si betonierja, zona e prodhimit, rrugët e brendshme dhe kufiri i parcelës. Matjet do të bëhen me pajisje standarde për matjen e nivelit të zhurmës.

Ujërat teknologjike do të kontrollohen në sedimentues dhe në pikën e daljes pas trajtimit. Sipas nevojës, do të analizohen parametrat që lidhen me përmbajtjen e lëndëve të ngurta, pH dhe

tregues të tjerë relevantë. Gjithashtu, do të kontrollohet rregullisht gjendja e sedimentuesit dhe funksionimi i tij.

Kontrolli i tokës, sipërfaqeve të punës, mbetjeve të betonit, vajrave dhe karburanteve do të realizohet kryesisht përmes inspektimit vizual periodik, me qëllim evidentimin e rrjedhjeve ose ndotjeve eventuale.

Monitorimi vizual i pluhurit, mbeturinave, ujërave teknologjike dhe gjendjes së pajisjeve do të bëhet rregullisht gjatë operimit. Matjet instrumentale të zhurmës dhe cilësisë së ajrit rekomandohet të realizohen periodikisht, së paku një herë në vit, si dhe në rast të ankesave, ndryshimeve të procesit të prodhimit ose kërkesës së autoritetit kompetent. Analizat e ujërave teknologjike do të kryhen periodikisht dhe sipas kushteve që përcaktohen në lejet përkatëse mjedisore dhe ujore.

8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Raportet për matjet dhe monitorimin e parametrave mjedisorë do të përmbajnë të dhënat bazë për lokacionin, datën dhe kohën e matjes, pikën ku është realizuar matja, metodën dhe pajisjet e përdorura, rezultatet e fituara, krahasimin me vlerat e lejuara sipas kërkesave përkatëse, si dhe vlerësimin e gjendjes mjedisore.

Në raport do të përfshihen rezultatet e matjeve të cilësisë së ajrit dhe pluhurit, nivelit të zhurmës, analizave të ujërave teknologjike, si dhe të dhënat nga kontrollet vizuale lidhur me gjendjen e tokës, menaxhimin e mbeturinave, sedimentuesin dhe funksionimin e pajisjeve.

Raportet do të përgatiten pas realizimit të matjeve periodike dhe do të ruhen nga operatori si pjesë e dokumentacionit mjedisor të kompanisë. Sipas kërkesës së autoritetit kompetent, rezultatet dhe raportet përkatëse do të dorëzohen për shqyrtim.

Në rast se gjatë monitorimit evidentohen tejkalime të vlerave të lejuara ose ndikime të paparashikuara, operatori do të ndërmarrë masa korrigjuese dhe, sipas nevojës, do të realizohen matje të përsëritura për të verifikuar efektivitetin e masave të ndërmarra.

8.6. Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Kompania do të sigurojë që rezultatet e monitorimit dhe matjeve mjedisore të jenë të dokumentuara dhe të disponueshme për autoritetet kompetente dhe, kur kërkohet, edhe për publikun e interesuar.

Në rast se nga matjet evidentohen tejkalime të vlerave të lejuara ose ndikime që mund të paraqesin rrezik për mjedisin apo shëndetin e njeriut, autoriteti kompetent do të kërkojë nga operatori që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për eliminimin ose zvogëlimin e këtyre

ndikimeve dhe për përmirësimin e gjendjes mjedisore. Pas zbatimit të masave, sipas nevojës, do të kryhen matje të përsëritura për të verifikuar efektivitetin e tyre.

Informimi i publikut do të realizohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në pëlqimin ose lejen mjedisore. Sipas kërkesës, rezultatet kryesore të monitorimit mund të vihen në dispozicion përmes dokumentacionit të kompanisë, njoftimeve përkatëse ose formave të tjera të komunikimit me publikun dhe institucionet kompetente.

8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Duke marrë parasysh natyrën e projektit, lokacionin dhe ndikimet e mundshme lokale, nuk kërkohet program ndërkufitar i monitorimit të ndikimit në mjedis. Projekti nuk pritet të shkaktojë ndikime ndërkufitare në ajër, ujëra, tokë apo biodiversitet. Monitorimi do të fokusohet në lokacionin e projektit dhe në afërsinë e drejtpërdrejtë të tij.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i Menaxhimit Mjedisor për bazën e prodhimit të betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit ka për qëllim përcaktimin e masave që duhet të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe pas përfundimit të funksionimit të projektit.

Gjatë fazës së ndërtimit, punimet duhet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lokacionit të projektit. Duhet të bëhet kontrolli i pluhurit, menaxhimi i mbeturinave ndërtimore, mirëmbajtja e makinerive dhe parandalimi i rrjedhjeve aksidentale të vajrave apo karburanteve. Materialet ndërtimore duhet të vendosen në hapësira të caktuara, ndërsa mbeturinat duhet të largohen në mënyrë të rregullt.

Gjatë fazës së operimit, kompania duhet të zbatojë masa për kontrollin e pluhurit nga agregati dhe çimentoja, mirëmbajtjen e pajisjeve prodhuese, funksionimin e filtrave në siloset e çimentos, trajtimin e ujërave teknologjike përmes sedimentuesit dhe menaxhimin e mbeturinave sipas llojit të tyre.

Ujërat sanitare do të grumbullohen në gropë septike të papërshkueshme nga uji, e cila duhet të mirëmbahet dhe të zbrazet nga operatorë të autorizuar. Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi nëntokësor, ndërsa përdorimi i ujit duhet të jetë i kontrolluar dhe në përputhje me nevojat e procesit të prodhimit.

Pas përfundimit të funksionimit të projektit, duhet të bëhet largimi i pajisjeve, pastrimi i lokacionit, largimi i mbeturinave dhe rehabilitimi i sipërfaqes së përdorur. Me zbatimin e këtyre masave, ndikimet në ajër, tokë, ujëra, peizazh dhe popullsinë përreth pritet të jenë të kufizuara dhe të menaxhueshme.

9.2. Pajtushmeria me pëlqim mjedisor

Kompania “IPN GROUP” SH.P.K. duhet të respektojë të gjitha kushtet që do të përcaktohen në pëlqimin mjedisor dhe në lejet tjera përkatëse. Aktiviteti duhet të zhvillohet vetëm sipas kapacitetit, lokacionit dhe mënyrës së funksionimit të paraqitur në këtë raport. Operatori duhet të zbatojë masat për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, menaxhimin e mbeturinave, kontrollin e zhurmës dhe sigurinë në punë. Çdo ndryshim i rëndësishëm në procesin e punës, kapacitetin prodhues apo shtrirjen e lokacionit duhet të bëhet vetëm pas njoftimit dhe miratimit nga autoritetet kompetente. Kompania duhet të mbajë evidencë për mirëmbajtjen e pajisjeve, menaxhimin e mbeturinave, funksionimin e sedimentuesit dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit.

9.3. Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Në kuadër të menaxhimit të ndikimeve mjedisore, kompania "IPN GROUP" SH.P.K. inkurajohet të zhvillojë sistem të menaxhimit mjedisor në përputhje me parimet e standardit ISO 14000.

Ky sistem do të ndihmojë në identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e ndikimeve që mund të paraqiten gjatë ndërtimit dhe funksionimit të bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit.

Zbatimi i këtij sistemi do të kontribuojë në:

- kontrollin më të mirë të pluhurit, zhurmës dhe emetimeve nga makineritë;
- menaxhimin e ujërave teknologjike përmes sedimentuesit;
- menaxhimin e ujërave sanitare përmes gropës septike të papërshkueshme nga uji;
- grumbullimin ndaras të mbeturinave dhe dorëzimin e tyre te kompanitë adekuate;
- mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve dhe makinerive;
- rritjen e përgjegjësisë mjedisore të punëtorëve;
- përmirësimin e dokumentimit, monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Zhvillimi i sistemit të menaxhimit mjedisor do të bëhet gradualisht, në përputhje me natyrën dhe kapacitetin e aktivitetit. Ky sistem do të ndihmojë që projekti të funksionojë në mënyrë më të kontrolluar, më të sigurt dhe më të qëndrueshme për mjedisin.

10. INFORMACIONE SHTESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shtesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së

Projekti për ndërtimin dhe funksionalizimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave dhe elementeve prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. është hartuar me qëllim vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe fazës së operimit. Karakteristikat kryesore të projektit lidhen me natyrën prodhuese të aktivitetit, përdorimin e agregatit, çimentos, ujit dhe aditivëve, si dhe funksionimin e pajisjeve për prodhimin e betonit dhe elementeve prej betonit. Procesi teknologjik është kryesisht mekanik dhe nuk përfshin djegie industriale apo procese të ndërlikuara kimike.

Në kuadër të aktivitetit do të bëhet pranimi dhe deponimi i agregatit, ruajtja e çimentos në silose, dozimi i materialeve, përzierja në mikser, prodhimi i betonit të freskët, si dhe prodhimi i kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit.

Betoni i freskët do të ngarkohet menjëherë në auto-mikserë dhe do të dërgohet te operatori apo klienti përkatës. Ndërsa kubëzat, tubat dhe elementet e tjera prej betonit do të vendosen në hapësira të përcaktuara për tharje, forcim dhe deponim të përkohshëm deri në transport.

Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi nëntokësor, ndërsa ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës do të trajtohen përmes sedimentuesit. Ujërat sanitare do të grumbullohen në gropë septike të papërshkueshme nga uji, e cila do të mirëmbahet dhe zbrazet nga operatorë të autorizuar.

Ndikimet kryesore mjedisore që janë marrë parasysh në këtë raport lidhen me pluhurin, zhurmën, qarkullimin e mjeteve transportuese, përdorimin e ujit, ujërat teknologjike, mbetjet nga betoni dhe mbeturinat komunale. Këto ndikime janë kryesisht lokale dhe të menaxhueshme me masa të përshtatshme teknike dhe organizative.

Informacionet e përfshira në këtë raport shërbejnë për përcaktimin e qëllimit, përmbajtjes dhe masave mbrojtëse të VNM-së, në mënyrë që projekti të zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe me ndikime të kontrolluara në mjedis.

11. BURIMET E TË DHËNAVE

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *TE DHËNAT NGA INVESTITORI,*
- *Kosovo Geoportal*
- *Ferizaj, 70000 to 42.4590494, 21.1666970 - Google Maps*
- *LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS*
- *Draft Plani Zhvillimor Komunal i Ferizajt 2017 – 2025*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR.04/2025 PËR PËMBAJTJEN, METODOLOGJINË DHE PËRPUTHSHMËRINË E RAPORTIT ME KËRKESAT LIGJORE , PRAKTIKAT E ZBATUESHME DHE ASPEKTET E TJERA TEKNIKE TË RAPORTIT*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHTETËROR TË MBETURINAVE*

12. SHTOJCA

1. Raporti i VNM-së i nënshkruar nga aplikuesi dhe personi fizik apo juridik i pajisur me licencë nga Ministria për hartimin e raporteve të VNM-së, me një (1) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike.
2. Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor.
3. Vlera investive e projektit në formë tabelare.
4. Certifikata e regjistrimit të biznesit.
5. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme.
6. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref.
7. Plani i rilevimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar, si dhe kopja e licencës së gjeodetit.
8. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, në rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e aplikuesit.
9. Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim/informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale dhe kushteve ndërtimore.
10. Licenca valide e personit fizik ose juridik, e lëshuar nga Ministria.

13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT

13.1. Hyrje

Projekti i propozuar ka të bëjë me ndërtimin dhe funksionalizimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., në parcelen me nr. P-72209079-00949-1 Zk, Babush i Serbëve, Komuna e Ferizajit, dhe sipërfaqja e kesja parcele eshte 16,919 m².

Baza prodhuese planifikohet të zhvillohet si aktivitet për prodhimin e betonit të freskët dhe produkteve të ndryshme prej betonit, të cilat do të përdoren për nevoja të ndërtimtarisë, infrastrukturës rrugore, kanalizimeve, rregullimit të hapësirave të jashtme dhe projekteve të tjera ndërtimore.

Procesi teknologjik do të përfshijë pranimin dhe deponimin e agregatit, ruajtjen e çimentos në silose, dozimin e materialeve, përzierjen në mikser, prodhimin e betonit të freskët, si dhe prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit. Betoni i freskët nuk do të deponohet në lokacion, por do të ngarkohet menjëherë në auto-mikserë dhe do të dërgohet te operatori apo klienti përkatës.

Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi nëntokësor, ndërsa ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës do të trajtohen përmes sedimentuesit. Ujërat sanitare do të grumbullohen në gropë septike të papërshkueshme nga uji.

Lokacioni ndodhet jashtë zonës së banimit. Vendbanimi më i afërt gjendet në distancë rreth 785.02 m nga lokacioni, ndërsa Lumi Nerodime gjendet në distancë rreth 215.9 m. Në afërsi të zonës ka edhe biznese dhe aktivitete të tjera afariste, çka tregon se lokacioni ka karakter të përzier ekonomik dhe prodhues.

Qëllimi i kësaj përmbledhjeje jo-teknike është paraqitja e shkurtër dhe e kuptueshme e projektit, ndikimeve të mundshme në mjedis dhe masave që do të zbatohen për mbrojtjen e ajrit, tokës, ujërave, shëndetit të njerëzve dhe mjedisit përreth.

13.2. Përshkrimi i projektit

Projekti përfshin ndërtimin dhe funksionalizimin e bazës për prodhimin e betonit të freskët, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K., në Babush të Serbëve, Komuna e Ferizajit.

Procesi i punës fillon me pranimin e lëndëve të para, si agregati, çimentoja, uji dhe aditivët. Agregati me fraksione të ndryshme do të deponohet në hapësira të caktuara brenda lokacionit dhe më pas do të vendoset në bunkerë me anë të lopatës ngarkuese. Çimentoja do të ruhet në silose të mbyllura, të cilat mbushen me auto-cisterna përmes sistemit pneumatik.

Nga bunkerët, agregati do të dozohet dhe do të bartet përmes transportierëve deri në mikser. Çimentoja do të dërgohet nga siloset në mikser përmes transportuesve kërmillorë dhe sistemit të peshimit. Uji dhe aditivët do të dozohen sipas recepturës së betonit që do të prodhohet. Procesi do të menaxhohet përmes sistemit komandues, i cili mundëson dozimin dhe kontrollin e materialeve.

Betoni i freskët, pas përzierjes në mikser, do të ngarkohet menjëherë në auto-mikserë dhe do të dërgohet te operatori apo klienti përkatës. Ai nuk do të deponohet në lokacion.

Për prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit, përzierja e betonit do të përgatitet me përbërje të përshtatur për formësim. Materiali do të vendoset në kallëpe ose pajisje për vibro-shtypje, pastaj produktet do të kalojnë në fazën e tharjes, forcimit dhe kontrollit të cilësisë. Pas kësaj, produktet do të deponohen përkohësisht në hapësirat e caktuara deri në transport.

Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi nëntokësor. Uji do të përdoret për prodhimin e betonit, prodhimin e elementeve prej betonit, larjen e pajisjeve dhe nevojat sanitare. Ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës do të trajtohen përmes sedimentuesit, ndërsa ujërat sanitare do të grumbullohen në gropë septike të papërshkueshme nga uji.

Procesi teknologjik është kryesisht mekanik dhe nuk përfshin djegie industriale apo procese kimike të ndërlikuara. Ndikimet kryesore të mundshme lidhen me pluhurin, zhurmën, qarkullimin e mjeteve transportuese, ujërat teknologjike dhe mbetjet nga betoni, të cilat do të menaxhohen përmes masave të parapara në raport.

13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse

Ndikimet kryesore mjedisore

Gjatë fazës së ndërtimit mund të paraqiten ndikime të përkohshme në mjedis, si pluhuri nga rregullimi dhe nivelimi i terrenit, zhurma nga makineritë, lëvizja e mjeteve transportuese dhe krijimi i mbeturinave ndërtimore. Po ashtu, mund të paraqitet rrezik i kufizuar nga rrjedhjet aksidentale të vajrave apo karburanteve nga makineritë.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet kryesore lidhen me pluhurin nga manipulimi me agregat dhe çimento, mbushja e bunkerëve, qarkullimi i kamionëve dhe puna e pajisjeve prodhuese. Zhurma mund të krijohet nga betoniera, pajisjet për prodhimin e kubëzave, tubave dhe elementeve prej betonit, auto-mikserët, lopata ngarkuese dhe makineritë tjera operative.

Ndikime të tjera mund të lidhen me ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës, mbetjet nga betoni, mbeturinat komunale dhe mbeturinat eventuale nga mirëmbajtja e

pajisjeve. Betoni i freskët nuk do të deponohet në lokacion, por pas prodhimit do të ngarkohet menjëherë në auto-mikserë dhe do të dërgohet te operatori apo klienti përkatës.

Duke marrë parasysh se vendbanimi më i afërt ndodhet rreth 785.02 m nga lokacioni, ndikimet ndaj popullsisë pritet të jenë të kufizuara dhe kryesisht lokale.

Masat mbrojtëse

Për zvogëlimin e ndikimeve gjatë ndërtimit duhet të bëhet organizimi i rregullt i punimeve, kufizimi i lëvizjes së makinerive brenda zonës së projektit, pastrimi i sipërfaqeve të punës dhe largimi i mbeturinave ndërtimore në mënyrë të kontrolluar.

Gjatë operimit, pluhuri duhet të kontrollohet përmes spërkatjes së rrugëve të brendshme gjatë periudhave të thata, pastrimit të sipërfaqeve operative, ruajtjes së çimentos në silose të mbyllura dhe mirëmbajtjes së filtrave në silose. Po ashtu, duhet të kufizohet shpejtësia e mjeteve brenda lokacionit.

Zhurma duhet të zvogëlohet përmes mirëmbajtjes së rregullt të pajisjeve, përdorimit të makinerive në gjendje të mirë teknike dhe respektimit të orarit të punës.

Ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve dhe sipërfaqeve të punës duhet të trajtohen përmes sedimentuesit. Ujërat sanitare duhet të grumbullohen në gropë septike të papërshkueshme nga uji, e cila duhet të mirëmbahet dhe të zbrazet nga operatorë të autorizuar.

Mbeturinat duhet të grumbullohen ndaras sipas llojit të tyre dhe të dorëzohen te kompanitë adekuate për trajtim, riciklim ose asgjësim. Me zbatimin e këtyre masave, ndikimet në mjedis pritet të jenë të kontrolluara dhe të menaxhueshme.

13.4. Përfitimet socio-ekonomike

Projekti pritet të ketë përfitime socio-ekonomike për zonën ku planifikohet të zhvillohet aktiviteti, pasi do të krijojë mundësi për punësim dhe do të mbështesë zhvillimin e sektorit të ndërtimtarisë.

Gjatë fazës së ndërtimit do të angazhohen punëtorë, makineri dhe shërbime të ndryshme për rregullimin e lokacionit, ndërtimin e bazës, objektit administrativ dhe vendosjen e pajisjeve prodhuese.

Gjatë fazës së operimit do të krijohen vende pune për operatorë të pajisjeve, shoferë, punëtorë të prodhimit, mirëmbajtës dhe staf administrativ. Projekti gjithashtu do të krijojë nevojë për bashkëpunim me furnitorë të agregatit, çimentos, transportues, kompani ndërtimore dhe shërbime të tjera përcjellëse.

Përfitim tjetër është furnizimi i tregut lokal dhe rajonal me beton të freskët, kubëza, tuba dhe elemente të tjera prej betonit, të cilat përdoren në ndërtimtari, infrastrukturë rrugore, kanalizime dhe rregullim të hapësirave publike e private.

Në përgjithësi, projekti pritet të kontribuojë në zhvillimin ekonomik lokal, rritjen e aktivitetit afarist dhe përmirësimin e furnizimit me produkte ndërtimore, ndërsa ndikimet mjedisore do të menaxhohen me masat e parapara në raport.

13.5. Përfundim

Projrojekti rojekti për ndërtimin dhe funksionalizimin e bazës për prodhimin e betonit, kubëzave, tubave dhe elementeve të tjera prej betonit nga kompania "IPN GROUP" SH.P.K. paraqet një aktivitet prodhues me rëndësi për sektorin e ndërtimtarisë dhe infrastrukturës.

Ndikimet kryesore të projektit lidhen me pluhurin, zhurmën, qarkullimin e mjeteve transportuese, ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve, mbetjet nga betoni dhe mbeturinat komunale. Këto ndikime pritet të jenë lokale dhe të menaxhueshme, si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës së operimit.

Betoni i freskët nuk do të deponohet në lokacion, por do të dërgohet menjëherë te operatori apo klienti përkatës me auto-mikserë. Ujërat teknologjike do të trajtohen përmes sedimentuesit, ndërsa ujërat sanitare do të grumbullohen në gropë septike të papërshkueshme nga uji. Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi nëntokësor.

Duke marrë parasysh distancën e vendbanimit më të afërt, natyrën mekanike të procesit, masat për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, si dhe mënyrën e menaxhimit të ujërave dhe mbeturinave, projekti mund të konsiderohet i pranueshëm nga aspekti mjedisor.

Realizimi i projektit rekomandohet me kusht që kompania të zbatojë masat mbrojtëse, monitoruese dhe rehabilituese të përcaktuara në raport, si dhe të respektojë kërkesat ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë.